

Planifikim dhe ide se si të mësohet libri

“Tregimet më të bukura – niveli i parë”

Leonora Breznica

Përgatitja e materialit të këtij libri ka marrë kohë të gjatë dhe dy herë është testuar në grup fëmijësh. Herën e parë tek grupmosha parashkollore dhe herën e dytë tek fëmijët 7-10 vjeç. Të metat dhe vendet ku është parë që ka nevojë të përmirësohen janë korrigjuar e rregulluar. Këtë planifikim dhe ide se si të nguliten këto njohuri bazike në mendjet e fëmijëve mysliman, in shaa Allah, do ua lehtësojnë punën prindërve dhe mësimeve (në kurse private për mësim besimin e fesë Islame).

Planin dhe planifikimin e këtij libri kam zgjedhur ta shkruaj në mënyrën më të thjeshtë. Pra, pa u zgjatur me fjalë zyrtare e ligjore, por vetëm ato që u hyjnë në punë dhe lehtësojnë sqarimin e kërkesave të librit si për mësimeve e prindërit, po ashtu edhe për vetë fëmijët.

Ky planifikim shumë lehtë mund të kombinohet me planifikimet e mësim-leximit të Kuranit.

“Tregimet më të bukura – niveli i parë” përmban:

5 libërtha (A-D), secili prej tyre 4 lëndë: **tregim, emrat e Allahut, akide dhe hadith**. Këto njohuri iu lehtësohen fëmijëve përmes ushtrimeve të ndryshme edhe duke u gërshetuar mes vete, si: fjalëkryqe, enigma të larmishme etj.

6 tregimet: “*Allahu i Lartësuar*”, “*Besimtarët e shpellës*”, “*Cilësitë e profetëve*”, “*Çudia tek hebrenjtë: lindja e Isait (alejhis selam)*” pjesa e parë (jeta e Merjemes) dhe “*Çudia tek hebrenjtë: lindja e Isait (alejhis selam)*” pjesa e dytë (jeta e Isait alejhis selam), “*Davudi (alejhis selam)*”.

9 emrat e Allahut: All-llahu, El-llahu, Err-Rrabu, Err-Rrahimu, Err-Rrahmanu, El-Azizu, El-Hakimu, El-Hamidu dhe El-Mexhidu.

5 mësimet nga mësim-besimi (akideja) me argumente në formë pyetje-përgjigje: “Cili është urdhri më i rëndësishëm?”, “Cila është e keqja më e madhe?”, “Përse Allahu i dërgoi profetët?”, “Cila është feja jote?”, “Cili është Profeti yt?”.

5 hadithet për mësim përmendsh: “**Shtyllat e Islamit**”, “**Bazat e Imanit**”, “**Profetët janë vëllezër ... feja e tyre është një (Islami).**” “**Çfarë u kam ndaluar largohuni prej tyre, ndërsa për çfarë u kam urdhëruar praktikojeni sa të mundeni.**” “**Veprat më të dashura tek Allahu janë ato që kryhen vazhdimisht, edhe nëse janë të pakta.**”

Orët: 36 javë – 9 muaj (java = një orë/ditë mësimdhënësi, ndërsa 6 orë/ditë shtëpi)*

Java e parë njoftim

A-ja = 6 javë	ilustrimi i kopertinës së libërthit A = 1 javë
B-ja = 5 javë	Aktivitet i përbashkët për dy libërthat A dhe B = 1 javë
C-ja = 5 javë	Test për tre libërthat A – C = 2 javë
Ç-ja = 6 javë	Aktivitet i përbashkët = 1 javë
D-ja = 5 javë	Garë diturie = 3 javë.

***Për shtëpi** - metodë e mirë formimi i një grupi në celular, ku çdo ditë pas përfundimit të detyrës raportohet për përfundimin e saj. Gjithashtu së bashku me librin rekomandohet të posedohen edhe katër fletore për katër lëndët që janë në të.

Shtator							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Prezantim mes vete. Njoftim me librin “Tregimet më të bukura – niveli i parë”. Plotësimi i faqes së parë të librit dhe bisedë e shkurtër rreth fjalëve të zbuluara.	Kontrollimi i ushtrimit të plotësuar në shkollë. Të shkruarit e emrit dhe vizatimi i figurave mbi secilën shkronjë të emrit.					

Shtator							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Leximi i tregimit “Allahu i Lartësuar” .	Leximi i tregimit “Allahu i Lartësuar” një herë brenda ditës.	Leximi i tregimit “Allahu i Lartësuar” anëtarëve të familjes, sikurse mësimdhënësi.	Shkrimi i gjysmës së parë të pyetjeve dhe përgjigjet e tyre në fletore.	Shkrimi i gjysmës së mbetur të pyetjeve dhe përgjigjet e tyre në fletore.	Leximi i pyetjeve dhe përgjigjeve nga fletorja, disa herë brenda ditës.	Aktivitet familjar: pyetjet dhe përgjigjet e tregimit “Allahu i Lartësuar”.

Shtator							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Leximi i pyetje-përgjigjeve. Fjalët e panjohura të tregimit. Plotësimi i ushtrimeve nga 1-4.	Kontrollimi i ushtrimeve të plotësuara dhe në shkollë.	Shkrimi i kuptimit të fjalëve të panjohura në fletore.	Leximi i kuptimit të fjalëve të panjohura disa herë brenda ditës dhe ushtrimi i tyre për mësim përmendsh.	Mësimi përmendsh i kuptimit të fjalëve të panjohura. Recitimi i tyre njërit prej anëtarëve të familjes.	Pyetjet lexohen nga libri, ndërsa fëmija u përgjigjet atyre përmendsh.	Prindërit pyesin fëmijët për mësimet e mësuara.

Shtator							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Përsëritje e lehtë e asaj që është mësuar deri tani. Plotësimi i ushtrimeve nga 5-9.	Kontrollimi i ushtrimeve të plotësuara dhe në shkollë.	Leximi i tregimit të mësuar.	Recitimi përmendsh dhe bukur i gjithë tregimit të mësuar.	Përsëritja e kuptimeve të fjalëve të panjohura.	Leximi dhe kontrollimi i gjithë ushtrimeve të mësuara.	Përsëritje e gjithë kësaj që është mësuar deri tani: tregimit, fjalëve të panjohura dhe ushtrimeve.

Tetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Hyrja në temën: Emrat e Allahut dhe njohja me emrin e parë të Tij. Plotësimi i ushtrimit 10-12.	Kontrollimi i ushtrimeve të plotësuara dje në shkollë. Veçantë të bëhet sa më e plotë pema e mendimeve.	Leximi i temës “Emrat e Allahut” pesë herë brenda ditës.	Shkrimi në fletore i emrit të parë të Allahut bashkë me argument. Leximi i tij disa herë.	Leximi komplet i temës “Emrat e Allahut” dhe emrit të parë të Tij deri në mësimin përmendsh të tij.	Fëmija ta interpretojë, pa shikuar në libër, se si na kanë mësuar dijetarët për emrat e Allahut dhe argumentet nga Kurani e Suneti.	Prindërit pyesin dhe fëmijët përgjigjen.

Tetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Përsëritje e thjeshtë. Mësimi i ri nga akideja: “Cili është urdhri më i rëndësishëm?” Plotësimi i ushtrimit 13-14.	Kontrollimi i ushtrimeve të plotësuara dje në shkollë.	Shkrimi në fletore mësimin: “Cili është urdhri më i rëndësishëm?”	Leximi i mësimit të akides disa herë deri në mësimin përmendsh të tij.	Përsëritja e tregimit “Allahu i Lartësuar” së bashku me fjalët e panjohura të tij.	Përsëritja e temës për emrat e Allahut dhe emrin All-llahu.	Recitohet para anëtarëve të familjes mësimi i akides si dhe përgjigjet ndonjë pyetjeje që zgjedhin ata për fëmijët nga mësimet e mësuara.

Tetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Mësimi i hadithit të parë: “Shtyllat e Islamit” . Plotësimi i ushtrimit 15 dhe faqja e fundit.	Kontrollimi i ushtrimit të plotësuar në shkollë. Leximi i hadithit të mësuar.	Shkrimi i hadithit në fletore dhe leximi i tij.	Leximi i hadithit dhe faqes së fundit të libërthit disa herë. Shkruan drejt (të sakta) fjalitë e ushtrimit të dytë të faqes së fundit tek fletorja “Tregimet më të bukura”.	Reciton hadithin si dhe diçka tjetër sipas dëshirës para anëtarëve të familjes.	Shfleton dhe kontrollon gjithë libërthin A.	Prindërit i pyesin fëmijët rreth njohurive të mësura deri tani.

Tetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Ilustrimi i kopertinës së libërthit A.	Kontrollon dhe shton e zbukuron ende kopertinën.	Lexim, së paku, 10 minuta në ditë nga libërthi A i librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 10 minuta në ditë nga libërthi A i librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 10 minuta në ditë nga libërthi A i librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 10 minuta në ditë nga libërthi A i librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 10 minuta në ditë nga libërthi A i librit “Tregimet më të bukura”.

Nëntor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Tregimi “ Besimtarët e shpellës ”. Fjalët e panjohura të nxjerra nga tregimi.	Leximi i tregimit dhe fjalëve të panjohura të tij.	Shkrimi në fletore i pyetjeve dhe përgjigjeve të tregimit.	Leximi i pyetjeve dhe përgjigjeve nga fletorja.	Leximi disa herë i fjalëve të panjohura për këtë tregim deri në mësimin përmendsh të kuptimeve të tyre.	Përsëritje e fjalëve të panjohura.	Prindërit i pyesin fëmijët rreth tregimit dhe fjalëve të panjohura të tij.

Nëntor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Kontrollimi i përgjigjeve. Plotësimi i ushtrimeve nga 1-6.	Kontrollimi i ushtrimeve të plotësuara dhe në shkollë.	Leximi i tregimit “Besimtarët e shpellës”. Shkrimi në fletore kuptimet e fjalëve të panjohura.	Kontrollimi dhe leximi i fjalëve të panjohura të dy tregimeve.	Fjalët e panjohura të dy tregimeve ua reciton ndonjë familjari, ku ai pyet ndërsa fëmija reciton përmendsh.	Përsëritje e njohurive të mësuara në këtë libërth.	Përsëritje e temës për emrat e Allahut dhe emrit të parë të Tij: All-llahu.

Nëntor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Dy emrat e Allahut: 2. El-Ilahu dhe 3. Err-Rabbu. Plotësimi i ushtrimeve nga 7-9.	Kontrollimi i ushtrimeve të plotësuara dhe në shkollë.	Shkrimi në fletore i dy emrave të Allahut: El-Ilahu dhe Err-Rabbu.	Leximi i tre emrave të shkruar në fletore deri në mësimin përmendsh të tyre.	Recitimi i tre emrave të Allahut anëtarëve të familjes.	Prindërit pyesin fëmijët rreth tre emrave të mësuar të Allahut dhe disa pyetje rreth njohurive të këtij libërthi.	Përsëritje e mësimit të parë nga akideja: teuhidi me argumentet për të.

Nëntor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Përsëritje e mësimit për <i>teuhidin</i> . Mësimi: “Cila është e keqja më e madhe?” Plotësimi i ushtrimit 10-12.	Kontrollimi dhe plotësimi i ushtrimeve të mësuar dhe në shkollë.	Leximi disa herë i mësimit: “Cila është e keqja më e madhe?” deri në mësimin përmendsh të tij.	Shkrimi në fletoren e mësim-besimit: “Cila është e keqja më e madhe?”	Recitimi përmendsh ndonjërit nga familjarët mësimin e teuhidit dhe shirkut.	Përsëritja e tregimit “Besimtarët e shpellës” me fjalët e panjohura të tij.	Përsëritja e dy emrave të fundit të Allahut dhe hadithit “Shtyllat e Islamit”.

Dhjetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Hadithi: “Bazat e imanit (besimit)”. Plotësimi i ushtrimit 13-15 dhe faqja e fundit. Orientim për plotësimin e kopertinës së libërthit.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dhe në shkollë.	Shkrimi në fletore hadithin e mësuar dhe leximi i tij deri në mësimin e tij përmendsh.	Ilustrimi i kopertinës së libërthit.	Shkrimi në fletoren “Tregimet më të bukura” dy ushtrimet e faqes së fundit.	Shfleton dhe kontrollon gjithë libërthnin B.	Prindërit pyesin fëmijët rreth njohurive të libërthit B.

Dhjetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Lojëra dhe punime në grup.	Lexim, së paku, 20 minuta në ditë nga dy libërthat e librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 20 minuta në ditë nga dy libërthat e librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 20 minuta në ditë nga dy libërthat e librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 20 minuta në ditë nga dy libërthat e librit “Tregimet më të bukura”.	Lexim, së paku, 20 minuta në ditë nga dy libërthat e librit “Tregimet më të bukura”.	Prindërit pyesin fëmijët rreth njohurive të mësuar.

Dhjetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Tregimi “ <i>Cilësitë e profetëve</i> ”.	Leximi i tregimit “ <i>Cilësitë e profetëve</i> ” disa herë brenda ditës.	Shkrimi në fletore pesë pyetjet e para të tregimit dhe përgjigjet për to.	Shkrimi në fletore nga pyetja e gjashtë deri te e dhjeta dhe përgjigjet e tyre.	Shkrimi në fletore pesë pyetjeve që kanë mbetur dhe përgjigjet për to.	Leximi dhe kontrollimi i pyetjeve dhe përgjigjeve nga fletorja të tregimit: “ <i>Cilësitë e profetëve</i> ”.	Leximi i tregimit “ <i>Cilësitë e profetëve</i> ”.

Dhjetor							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Plotësimi i ushtrimeve nga 1-6.	Kontrollimi dhe plotësimi i ushtrimeve të punuara dje në shkollë.	Leximi i tregimit “ <i>Cilësitë e profetëve</i> ”.	Leximi i pyetje-përgjigjeve të tregimit “ <i>Cilësitë e profetëve</i> ” nga fletorja.	Shfletimi dhe kontrollimi i të gjitha ushtrimeve të mësuara deri tani.	Prindërit pyesin fëmijët rreth njohurive të mësuara (mundësi e lehtë: pyetjet e fjalëkryqit).	Përsëritje e emrave të Allahut.

Janar							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Emrat e Allahut: Err-Rrahmanu dhe Err-Rrahimu. Plotësimi i ushtrimeve nga 7-9.	Kontrollimi dhe plotësimi i ushtrimeve të punuara dhe në shkollë.	Leximi disa herë me vëmendje të dy emrave 4 dhe 5 të Allahut.	Shkrimi i këtyre dy emrave në fletoren: “Emrat e Allahut”.	Leximi dhe përsëritja e pesë emrave të Allahut.	Leximi dhe përsëritja e pesë emrave të Allahut ndonjë familjari apo shoku.	Përsëritja e dy mësimëve nga akideja: <i>Teuhidi</i> dhe <i>Shirku</i> së bashku me argumentet e tyre.

Janar							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Mësimi: “Përse Allahu i dërgoi profetët?” Plotësimi i ushtrimeve 10-11.	Kontrollimi dhe plotësimi i ushtrimeve të punuara dhe në shkollë.	Shkrimi në fletore mësimin: “Përse Allahu i dërgoi profetët?”	Leximi i mësimit të ri deri në mësimin e tij përmendsh.	Leximi dhe përsëritja e tregimit dhe emrave të Allahut.	Prindërit pyesin fëmijët për mësimet e libërthit C: tregimin, dy emrat e Allahut dhe mësimin e akidesë.	Përsëritja e dy haditheve të mësuara. Shfleton njohuritë e reja nga libërthi i fundit.

Janar							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Hadithi i tretë. Plotësimi i ushtrimit 12 dhe faqja e fundit. Orientim për plotësimin e kopertinës së libërthit.	Kontrollimi dhe plotësimi i ushtrimeve të punuara dje në shkollë.	Shkrimi në fletore hadithin e ri dhe leximi i tij deri në mësimin përmendsh të tij.	Ilustrimi i kopertinës së libërthit.	Kontrollon dhe shton e zbukuron ende kopertinën.	Shkrimi në fletoren “Tregimet më të bukura” dy ushtrimet e faqes së fundit.	Prindërit pyesin fëmijët rreth njohurive të libërthit C.

Janar							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Parapërgatitje për testim të tre libërthave.	Leximi dhe përsëritja e gjysmës së parë të libërthit A (tregimit dhe emrave të Allahut).	Leximi dhe përsëritja e gjysmës së dytë të libërthit A (akideja dhe hadithi).	Leximi dhe përsëritja e gjysmës së parë të libërthit B (tregimit dhe emrave të Allahut).	Leximi dhe përsëritja e gjysmës së dytë të libërthit B (akideja dhe hadithi).	Leximi dhe përsëritja e gjysmës së parë të libërthit C (tregimit dhe emrave të Allahut).	Leximi dhe përsëritja e gjysmës së dytë të libërthit C (akideja dhe hadithi).

Shkurt							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Testimi për tre libërthat e parë, A-C. (*Testi në fund të këtij materiali).	Leximi i mësimëve të mësuara, së paku, 20 minuta në ditë.	Leximi i mësimëve të mësuara, së paku, 20 minuta në ditë.	Leximi i mësimëve të mësuara, së paku, 20 minuta në ditë.	Leximi i mësimëve të mësuara, së paku, 20 minuta në ditë.	Leximi i mësimëve të mësuara, së paku, 20 minuta në ditë.	Leximi i mësimëve të mësuara, së paku, 20 minuta në ditë.

Shkurt							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Pjesa e parë e tregimit “Çudia tek hebrenjtë: lindja e Isait (alejhis selam)” . Plotësimi i ushtrimit 1-2.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dhe në shkollë.	Leximi i tregimit dhe fjalëve të panjohura. Përgjigjet e shtatë pyetjeve të para të tregimit në fletore.	Përgjigjet e pyetjeve të fundit të tregimit në fletore.	Leximi dhe kontrollimi i pyetjeve dhe përgjigjeve nga fletorja.	Shkrimi në fletore i këtyre fjalëve të panjohura: cilësi, mysliman, modest, turp.	Prindërit lexojnë pyetjet e mësimi dhe fëmijët përgjigjen për to.

Shkurt							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Leximi i pyetje-përgjigjeve të pjesës së parë. Pjesa e dytë e tregimit “Çudia tek hebrenjtë: lindja e Isait (alejhis selam)” .	Leximi i pjesës së dytë të tregimit së bashku me fjalët e panjohura disa herë.	Përgjigjet e pyetjeve të tregimit në fletore (pjesës së dytë).	Leximi dhe kontrollimi i pyetjeve dhe përgjigjeve nga fletorja.	Shkrimi në fletore i këtyre fjalëve të panjohura: Bejtul Makdis, shejtanë, kokëfortë dhe Dexhali.	Leximi i dy pjesëve të tregimit së bashku me fjalët e tyre të panjohura.	Prindërit lexojnë pyetjet e mësimit dhe fëmijët përgjigjen.

Shkurt							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Leximi i pyetje-përgjigjeve të pjesës së dytë. Plotësimi i ushtrimit 3-5.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dhe në shkollë.	Leximi dhe mësimi përmendsh i ushtrimit 5.	Leximi i dy pjesëve të tregimit së bashku me fjalët e panjohura të tyre.	Leximi i pyetje-përgjigjeve të dy pjesëve të tregimit.	Leximi dhe kontrollimi i ushtrimeve të dy pjesëve të tregimit.	Përsëritja e pesë emrave të Allahut së bashku në aktivitet familjar.

Mars							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Dy emrat e Allahut: 6. El-Azizu dhe 7. El-Hakimu. Plotësimi i ushtrimit 6-7.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dje në shkollë.	Shkrimi në fletore i dy emrave të ri të Allahut që mësuam, pastaj leximi i tyre së paku pesë herë.	Recitimi i dy emrave të ri të Allahut anëtarëve të familjes.	Leximi dhe përsëritja e shtatë emrave të Allahut deri në dallimin e tyre nga njëri tjetri.	Leximi i tregimit “Çudia tek hebrenjtë: lindja e Isait (alejhis selam)”.	Prindërit pyesin fëmijët për tri mësimet nga akideja.

Mars							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Mësimi: “ Cila është feja jote? ” Plotësimi i ushtrimit 8-9.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dje në shkollë.	Leximi dhe shkrimi në fletore mësimin e ri: “Cila është feja jote?”.	Përsëritja dhe të recituarit familjes mësimin e ri të akidesë.	Leximi i pyetje-përgjigjeve të dy pjesëve të tregimit të fundit.	Leximi i fjalëve të panjohura të dy pjesëve të tregimit dhe i dy emrave të Allahut.	Prindërit pyesin fëmijët për tri hadithet e mësuara, pa harruar edhe ndonjë pyetje nga mësimet e këtij libërthi.

Mars							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Hadithi i katërt. Plotësimi i ushtrimit 10 dhe faqja e fundit. Orientim për plotësimin e kopertinës së libërthit.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dje në shkollë.	Shkrimi në fletore hadithin e ri dhe leximi i tij deri në mësim përmendsh.	Ilustrimi i kopertinës së libërthit.	Kontrollon dhe shton e zbukuron ende kopertinën.	Fjalitë e ushtrimit B të faqes së fundit i shkruan të gjitha të sakta në fletoren “Tregimet më të bukura”.	Prindërit pyesin fëmijët rreth njohurive të libërthit Ç.

[illegible]

Prill							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Tregimi: “Davudi (alejhis selam)” . Plotësimi i ushtrimeve nga 1-4.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dje në shkollë.	Leximi i tregimit së bashku me fjalët e panjohura.	Përgjigjet e pyetjeve të tregimit në fletore.	Leximi dhe kontrollimi i pyetje-përgjigjeve nga fletorja.	Leximi i tregimit. Nga ushtrimi 3: fjalitë e pasakta i shkruani në fletore të kthyer në të sakta.	Prindërit pyesin dhe u ndihmojnë fëmijëve në përsëritjen e shtatë emrave të Allahut.

Prill							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Mësimi i dy emrave të Allahut: 8. El-Hamidu dhe 9.El-Mexhidu. Plotësimi i ushtrimeve 5-7.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dje në shkollë.	Shkrimi i dy emrave të ri në fletore. Leximi i tyre me vëmendje.	Mësimi përmendsh i dy emrave të Allahut: El-Hamidu dhe El-Mexhidu.	Leximi 10 herë i ushtrimit 7 të plotësuar.	Përsëritja vetëm e argumenteve që kemi marrë për emrat e Allahut.	Prindërit pyesin dhe u ndihmojnë fëmijëve në përsëritjen e nëntë emrave të Allahut.

Prill							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Përsëritje e emrave të Allahut. Plotësimi i ushtrimit 8. Punimi i gjashtë emrave të Allahut në grup.	Kontrollimi dhe plotësimi i ushtrimit të punuara dje në shkollë.	Leximi dhe përsëritja e pesë emrave të parë të Allahut.	Leximi dhe përsëritja e katër emrave të fundit të Allahut.	Formulon vetë nga një pyetje për çdo tregim të mësuar, pastaj shkruan në fletore së bashku me përgjigjet e tyre.	Leximi 10 herë i ushtrimit 8 të plotësuar.	Prindërit pyesin dhe u ndihmojnë fëmijëve në përsëritjen e katër mësimëve nga akideja.

Prill							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Përsëritje e shkurtër rreth katër mësimëve të akides. Mësimi: “Cili është Profeti yt?” Ushtrimi 9-10.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dje në shkollë.	Shkrimi në fletore mësimin e ri: “Cili është Profeti yt?” . Leximi i saj disa herë.	Recitimi përmendsh i mësimit: “Cili është Profeti yt?” .	Leximi i tregimit: “Davudi (alejhis selam)” dhe pyetje – përgjigjet e tij.	Përsëritja e dy emrave të fundit të Allahut: El-Hamidu dhe El-Mexhidu, si dhe mësimi: “Cili është Profeti yt?” .	Prindërit pyesin dhe u ndihmojnë fëmijëve në përsëritjen e katër haditheve të mësuara.

Maj							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
1	Hadithi i pestë. Plotësimi i ushtrimit 10 dhe faqja e fundit. Orientim për plotësimin e kopertinës së libërthit.	Kontrollimi dhe plotësimi i detyrave të punuara dje në shkollë.	Shkrimi në fletore hadithin e ri dhe leximi i tij deri në mësimin përmendsh.	Ilustrimi i kopertinës së libërthit.	Kontrollon dhe shton e zbukuron ende kopertinën. Përsërit hadithin e ri.	Fjalitë e ushtrimit B të faqes së fundit i shkruan të gjitha të sakta në fletoren "Tregimet më të bukura".	Prindërit pyesin fëmijët rreth njohurive të libërthit D.

Maj							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
2	Parapërgatitje për garën e diturisë.	Leximi i tregimeve, së paku 5 herë brenda ditës.	Leximi i fjalëve të panjohura 10 herë.	Leximi i pyetje-përgjigjeve të tregimeve së paku 5 herë.	Leximi i temës hyrëse për emrat e Allahut. Përsërit dhe shkruan emrat e Allahut arabisht dhe shqip.	Leximi i kuptimeve të emrave të Allahut së paku 10 herë.	Leximi i argumenteve të emrave të Allahut.

Maj							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
3	Parapërgatitje për garën e diturisë.	Lexon tre mësimet e para të akidesë së paku 10 herë.	Lexon dy mësimet e fundit të akidesë, së bashku me ushtrimin 10 të libërthit D.	Përsërit pesë hadithet e mësuara së paku 5 herë.	I reciton para të tjerëve hadithet e mësuara.	Prindërit i pyesin fëmijët pyetje nga libri “Tregimet më të bukura – niveli i parë”.	Prindërit i pyesin fëmijët pyetje nga libri “Tregimet më të bukura – niveli i parë”.

Maj							
Java	E hënë Shkollë	E martë Shtëpi	E mërkurë Shtëpi	E enjte Shtëpi	E premte Shtëpi	E shtunë Shtëpi	E diel Shtëpi
4	Gara e diturisë.	Gjatë pushimit nuk kërkohet raportim, mirëpo prindërit kujdesen që fëmijët të lexojnë çdo ditë së paku 20 minuta nga libri “Tregimet më të bukura – niveli i parë”.					

Planifikimi

Muaji shtator, java e parë

Përshëndetja mes fëmijëve dhe mësimeve me selam.

Prezantohet mësimeve para fëmijëve.

Mësimeve:

- Tani na tregoni ju, fëmijë të dashur, si quheni, në këtë formë: "Unë quhem (emri mbiemri), po ti motra ime si quhesh?" (në grupin e vajzave); apo për grupin e djemve: "Unë quhem (emri mbiemri), po ti vëllai im si quhesh?" Dhe kështu mësojmë emrat e njëri tjetrit dhe shoqërohemi mes vete.

- Pasi u njohëm me emrat e njëri tjetrit të **njihemi shkurtimisht me mësimin dhe librin** që do mësojmë së bashku. Dija, të cilën e do Allahu më së shumti është dija për fenë tonë dhe veçanërisht për Allahun, Zotin tonë. Librat me të cilët do mësojmë ndër vite kanë të njëjtin titull vetëm se ndahen në nivele. Një nivel ka brenda tij disa libërtha, të cilët janë ndarë sipas alfabetit të gjuhës shqipe. Sa shkronja i ka alfabeti i gjuhës shqipe? Ju lumtë! Gjuha shqipe ka tridhjetë e gjashtë shkronja dhe niveli i parë ka pesë shkronjat e para të tij. Cilat janë pesë shkronjat e para të alfabetit të gjuhës shqipe? Shumë bukur, këtë vit do mësojmë me libërthas që kanë shkronjat A, B, C, Ç dhe D.

- Si do mësojmë? **Së pari fillohet me një tregim**, titulli i të cilit fillon me shkronjën përkatëse. Për shembull te shkronja A për kë është tregimi? A – Allahu, pra për Allahun e Lartësuar. Vazhdohet me fjalët e panjohura që hasen në tregim dhe pyetjet për të. Pyetjet na ndihmojnë të kuptojmë më mirë tregimin. Për të na e lehtësuar akoma më tepër të kuptuarit e mësimi kemi dhe ushtrime të ndryshme, interesante e tërheqëse për të gjitha lëndët/mësimet/temat.

- **Pas kësaj kemi një lëndë të re, e cila është për emrat e bukur të Allahut.** Keni dëgjuar më herët për emrat e Allahut apo sa emra ka Ai? E kemi një thënie të Profetit tonë të dashur, Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem) ku thotë që kush i mëson emrat e Allahut, e di kuptimin e tyre dhe punon sipas atyre, do të futet në Xhenet. Elhamdulillah! Prandaj duke e dashur ne shumë Allahun dhe shpërblimin e Tij do mësojmë këta emra të bukur shkurtimisht, të cilët për t'i mbajtur më lehtë në mend e për t'i kuptuar janë nxjerrë nga tregimet (lidhen me tregimet).

- **Lëndë tjetër**, e cila po ashtu është shumë e rëndësishme, **është akideja apo mësim-besimi**. Kjo lëndë është në formë pyetje-përgjigje dhe kjo formë është shumë më e kapshme sidomos për fëmijët.

- **Tema e fundit është baza e dytë e fesë Islame.** E dini nga e merr myslimani dijen? Dijen myslimani e merr nga dy burime: Kurani dhe Suneti. Pra do mësohet nga një hadith, prej haditheve më të njohura, për çdo libërth.

- Dhe faqja e fundit është **përmbledhja e njohurive të atij libërthi** duke i përsëritur ato përmes ushtrimeve.

- Punë, po ashtu me rëndësi, është dhe ilustrimi i kopertinave të çdo libërthi. Kopertina ilustrohet pasi të përfundojë mësimi i libërthit përkatës, pasi aty do paraqiten njohuritë e mësuara në të.
- Sot do fillojmë me faqen e parë të librit. Janë pesë fjali, ku shkruan: Emri im, Unë jam, Më së shumti e dua, Feja ime është, dhe Unë e ndjek. Së pari t'i zbulojmë këto katër fjalët duke shkruar shkronjën e parë me të cilën fillon emri i figurës tek katrori nën të.
 - Si është (qenka) vazhdimi i fjalisë: Unë jam?
 - Kë e duam ne më së shumti?
 - Kush është feja jonë?
 - Kë e ndjekim? Pra, veprojmë e sillemi sipas shembullit të kujt?
- Ndërsa për në shtëpi do shkruani emrin e juaj me figura të cilat fillojnë me ato shkronja. T'ju përkujtojmë që figurat e përzgjedhura të mos jenë gjallesa, pasi gjallesat që kanë shpirt Profeti ynë (salAllahu alejhi ue selem) na ka mësuar që nuk duhet të vizatohen.
- Dhe në fund: Allahu ua shtoftë dijen e dobishme! Esselamu alejkum!



Muaji shtator, java e dytë

Përsëritja mes fëmijëve dhe mësimeve me selam.

Mësimdhënësi:

- Javën e kaluar zbuluam disa fjalë të cilat fshiheshin pas disa figurave. Cilat ishin ato?
- Të shikojmë si i keni zbuluar emrat e juaj! Të shikojmë cilat figura bëjnë pjesë tek emri juaj! Shumë bukur, Allahumme barik! Allahu ju shpërbleftë me të mira që keni përfunduar detyrën! Amin!
- Këto fjalë dhe fjali që kemi punuar javën e kaluar do t'i kuptojmë e mësojmë rreth tyre më shumë në javët e ardhshme. Si ua merr mendja për kë ose me çfarë duhet të fillohet mësimi i dijes? Cila dije i paraprinë të gjitha tjerave?
- Po pra, për Allahun. Kush është Allahu? Ja të lexojmë tregimin e parë "Allahu i Lartësuar".

Lexon mësimdhënësi sipas teknikës së mësimdhënies DLTA, dëgjim dhe mendim i drejtuar. Pra, mësimdhënësi lexon me zë e fëmijët dëgjojnë. Ky lexim bëhet me ndalesa për t'u parashtruar fëmijëve pyetje nga pjesa e lexuar (pyetjet e dhëna në fund të mësimit). Në mes të pyetjeve fëmijëve u lihet hapësirë të mendojnë. Ata duhet të japin përgjigje të plota.

P.sh. për pjesën:

"Zoti ynë është Allahu.

Allahu është Një dhe i Vetëm.

Allahu është i Pari, para të Cilit s'ka pasur gjë tjetër.

Ai është i Fundit, pas të Cilit s'ka gjë tjetër.

Ai është më i Larti, mbi të Cilin s'ka gjë tjetër.

Gjithashtu, Allahu është i Afërti; me dijen e Tij është më afër krijesave se vetë ato.

Të gjithë kanë nevojë për Të, ndërsa Ai nuk ka nevojë për asgjë. Allahu kontrollon çdo gjë.

Allahu nuk ka prindër. Ai nuk ka as fëmijë. Asgjë nuk është sikurse Allahu.

Allahu është lartë mbi shtatë qiej, mbi Arsh. Allahu është mbi çdo gjë.

Allahu na ka krijuar neve që ta adhurojmë vetëm Atë pa i shoqëruar asgjë. Na ka krijuar t'i bindemi Atij duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij."

Ndalon këtu dhe iu drejtohet fëmijëve:

- Më tregoni ju. Kush është Zoti ynë? Përgjigjet duhet të jenë të plota. Tani për këtë pyetje nuk përgjigjeni vetëm "Allahu", por duke përdorur fjalët e pyetjes (i ktheni në fjali dëftore) formoni përgjigjen: "Zoti ynë është Allahu.". Dhe kështu me radhë.

- Vazhdojmë me pyetje të tjera. Tregona diçka për Allahun. Ku është Allahu? A ka Allahu prindër? Po fëmijë a ka? Përse na ka krijuar Allahu? Si i bindemi ne Atij?”

Pastaj tregimi ndahet në rreshta të caktuar në atë mënyrë që të arrijnë të gjithë fëmijët për të lexuar pjesë nga ai.

- Allahu ju gëzoftë fëmijë të mbarë! Tani t'ju tregoj që do ta formojmë një grup me numrat e celularëve të prindërve tuaj. Aty çdo ditë do të takohemi për të mësuar dhe lehtësuar mësimin e fesë tonë të bukur. Në mëngjes do e shkruaj kërkesën për atë ditë dhe ju brenda ditës, kur të përfundoni atë, do na lajmëroni në grup që është kryer detyra. Në rregull? Kaq për sot, esselamu alejkum!

Mesazhi i mundshëm i mësimdhënësit në grupin e raportimit të mësimave dhe detyrave.

Shtator, java e dyte, dita e dytë:

Esselamu alejkum ue rahemtullahi ue berekatuhu!

Për sot do të lexoni tregimin e bukur “Allahu i Lartësuar”, ky lexim do ua marrë 10 minuta më e shumta. Leximi i tij është detyrë vetëm një herë, ndërsa kush do më shumë herë, mundet të shkruaj në raportim se sa herë e ka lexuar.

Shembull se si të shkruhet raportimi:

Numri i renditjes së fëmijës gjatë raportimit të asaj dite dhe emri i tij.
P.sh.:

1. Muhamedi

Elhamdulillah e lexova tregimin e bukur “Allahu i Lartësuar”.

Dita e tretë e kësaj jave:

Dëshironi të bëheni mësues? Sot do e luani rolin tim në familjen tuaj. Lexojeni tregimin sikurse mësues dhe familja iu dëgjon, gjithashtu parashtrooni dhe pyetjet.

Elhamdulillah e lexova tregimin: “Allahu i Lartësuar”, para prindërve dhe u kënaqëm shumë.

Dita e katërt e kësaj jave:

Do të ndani një fletore të veçantë, ku do ta titulloni “Tregimet më të bukura”. Në të do të shkruani vetëm gjysmën e parë të pyetjeve dhe përgjigjet e tyre. Për të kursyer kohën, fotografoni detyrat e bëra dhe kur raportoni i dërgoni dhe ato.

Elhamdulillah i përfundova pyetjet dhe përgjigjet e tregimit “Allahu i Lartësuar”.

Dita e pestë e kësaj jave:

Ndërsa sot do vazhdoni përgjigjen e pjesës së fundit të pyetjeve të tregimit. Foton mos harroni.

Dita e gjashtë e kësaj jave:

Sot do lexoni disa herë pyetjet dhe përgjigjet e tregimit të shkruara në fletore.

Elhamdulillah i lexova pyetjet dhe përgjigjet e tregimit “Allahu i Lartësuar” pesë herë.

Dita e shtatë e kësaj jave:

Detyra si dje pak a shumë, vetëm se sot do e organizoni me familjen. Aktiviteti familjar organizohet në atë mënyrë ku me radhë njëri anëtar bën pyetjen dhe tjetri anëtar i familjes jep përgjigjen e saj, kështu vazhdohet deri në fund të tyre.

Elhamdulillah së bashku me familjen time i lexuam pyetjet dhe iu përgjigjëm atyre.

Muaji shtator, java e tretë

Mësimdhënësi pas kontrollimit të detyrave të shtëpisë:

- Allamme barik, fëmijë të zgjuar e punëtorë! Allahu ju shpërbleftë me të mira për detyrat e përfunduara dhe raportimin në grupin tonë! Tani, kështu si jeni të ulur nga fëmija i parë do fillojmë leximin e pyetjes së parë, pastaj pyetjen e dytë fëmija afër tij e kështu me radhë.



- Në rregull. Ka ndonjë fjalë në këtë tregim që nuk e kuptoni?
- Këtu kemi pesë fjalë të panjohura. Dëgjoni me vëmendje atë që e lexoj unë!

Pas leximit nga mësimdhënësi lexohen pastaj kuptimet e fjalëve të panjohura dhe nga fëmijët.

- Për t'i lehtësuar dhe mbajtur mend më gjatë mësimet që marrim do plotësojmë ushtrime të ndryshme me të cilat edhe do kënaqemi së bashku. Këto ushtrime mund të përdoren dhe në lojërat me fëmijët e familjes së gjerë dhe me anëtarët e familjes së ngushtë në kohën kur jeni së bashku. Të fillojmë me ushtrimin e parë të këtij libërthi.

- Së pari ndani tri ngjyra sipas dëshirës, pastaj rrumbullakoni shkronjat e tri fjalëve të titullit të tregimit. Shembull, me ngjyrën e kuqe i gjejmë duke rrumbullakuar shkronjat e fjalës “Allahu”, pastaj me ngjyrën e kaltër shkronjën “i” dhe në fund me ngjyrën e gjelbër shkronjat e fjalës “Lartësuar”. Allahu ju dhëntë sukses!

- Ushtrimi i dytë është shumë i bukur. Kemi pesë fjali, fjalët e të cilave nuk janë të renditura drejt. Lexoni fjalët si janë dhënë dhe shkruani nën to fjalinë si duhet.
- Ushtrimi i tretë kemi përsëri fjali që janë marrë nga tregimi. Në këto gjashtë fjali janë hequr disa fjalë, të cilat ju do i gjeni cila tek cila fjali duhet të jenë.
- Tek ushtrimi i katërt dhe i fundit për sot: shikoni këta dy rreshta, cilat fjalë janë të shkruara? Fjala “Allahu” dhe “Një”. E rrethoni fjalën e cila është ndryshe brenda rreshtit që është. Shumë mirë, ma sha Allah. Pse është ndryshe fjala e tretë e emrit Allahu? Sepse kjo fjalë është shkruar me të gjitha shkronjat e mëdha.
- Shumë mirë, tani me radhë do lexoni nga një fjali, si e keni plotësuar atë nga ushtrimi i dytë deri tek i katërti.
- Allahu ju ruajttë dhe dëgjohemi ditët me radhë në grupin e raportimeve. Esselamu alejkum!



Mesazhet e mundshme të mësimdhënësit në grupin e raportimeve:

Dita e tretë e kësaj jave:

Fjalët e panjohura së bashku me kuptimet e tyre i shkruani në fletoren “Tregimet më të bukura”, pastaj lexoni ato nga fletorja. Raportoni së bashku me fotot e detyrave të bëra.

Elhamdulillah i kam shkruar fjalët e panjohura në fletore dhe i lexova ato.

Dita e katërt e kësaj jave:

Dje i keni shkruar dhe lexuar fjalët e panjohura të tregimit. Sot raportoni atëherë kur i keni mësuar përmendsh kuptimet e tyre.

Elhamdulillah i mësova përmendsh fjalët e panjohura tek tregimi “Allahu i Lartësuar”.

Dita e pesë e kësaj jave:

Dje lexuat fjalët e panjohura të tregimit dhe mësuat përmendësh ato. Sot raportoni atëherë kur do t'ua recitoni ato përmendsh ndonjë familjari tuaj.

Elhamdulillah ia recitova përmendsh (cek kujt) fjalët e panjohura.

Dita e gjashtë e kësaj jave:

Pyetjet e mësimet filloni me radhë një nga një t'i lexoni nga libri, ndërsa u përgjigjeni atyre pa shikuar askund, përmendsh.

Elhamdulillah i recitoja pa problem përgjigjet e pyetjeve të tregimit “Allahu i Lartësuar”.

Muaji shtator, java e katërt

Mësimdhënësi:

- Të gjithë i keni të plotësuar katër ushtrimet e para, elhamdulillah. Allahu ua shtoftë dijen e dobishme! Sot do vazhdojmë me pesë ushtrimet e radhës për t'u argëtuar dhe shtuar akoma më shumë të kuptuarit e njohurive të mësuara.
- Ushtrimi i pestë. Janë dy kolona të cilat do lidhen së bashku (kolona e parë me të dytën) për të formuar fjali kuptimplota dhe të drejta. Pra tek e para: “Allahu na ka krijuar neve”, me kë duhet të lidhet nga kolona e dytë? Po pra, Allahu na ka krijuar neve që ta adhurojmë vetëm Atë, pa i shoqëruar asgjë. Kështu vazhdohet me katër fjalitë e radhës.

Pas plotësimit i lexojnë zgjidhjet fëmijë të ndryshëm.

- Ushtrimi i gjashtë. Keni dëgjuar për pesëvargëshin më herët? Pesëvargëshi është një vjershë me pesë rreshta. Ai është teknikë e mësimdhënies, e cila na përshtatet shumë bukur tek mësimet tona. Rreshti i parë përmban një emër, i cili e përshkruan temën; Rreshti i dytë e përshkruan temën me dy mbiemra - pra cilësitë e emrit; Rreshti i tretë përmban tri folje – pra tri veprime të emrit; Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë për emrin; dhe rreshti i pestë përmban një sinonim të emrit – pra fjalë që ka kuptim të njëjtë me emrin. Meqë është pesëvargëshi i parë, i kemi ndihmesat në anën e djathtë dhe vetëm do i zgjedhim disa prej tyre.
- Lexojeni si e keni formuar pesëvargëshin për Allahun!
- Ushtrimi i shtatë. Për çdo libërth do ta kemi nga një fjalëkryq që ka lidhje me mësimet tona. Keni plotësuar ju apo keni ndihmuar dikë të plotësojë më parë ndonjë fjalëkryq? Fjalëkryqi është lojë zbavitëse, që bëhet duke plotësuar çdo katror të një figure me shkronja të tilla që të formohen fjalë në të gjitha drejtimit. Meqë është fjalëkryqi i parë, ky është

ofruar vetëm duke i përshkruar fjalët e dhëna në të majtë të tij. Fjalëkryqi plotësohet me shkronja të mëdha. Plotësojeni këtë fjalëkryq me pesëmbëdhjetë krijesa të Allahut, të cilat ne i shohim.

- Ushtrimi i tetë. Tani, krijesat e Allahut me të cilat e plotësuam fjalëkryqin, i kemi në këtë peizazh të bukur. Gjeji ato duke shkruar numrin që e kanë emrat e tyre te fjalëkryqi, si në shembull. Pra, tek numri 1 në fjalëkryq cila fjalë ishte e shkruar? Po, ashtu është, është e shkruar fjala YJET. Ku kemi yje në këtë peizazh? I kemi tri yje të cilat e kanë të shkruar numrin 1. Cila krijesë e Allahut është e shkruar në fjalëkryq te numri 2? Shumë bukur, është e shkruar PEMËT. Shkruani tek pemët numrin 2. Po 3 kush është? Janë GJETHET, shkruani numrin 3 tek gjethet. E kështu me radhë deri të përfundojnë të gjitha. Në shtëpi do e ngjyrosni peizazhin pasi të përfundoni me gjetjen e fjalëve.

- Ushtrimi i fundit për sot e ka emrin Sudok. Çka është sudoku? Sudoku është një enigmë, e cila ka për bazë gjetjen e katër apo gjashtë apo nëntë numrave duke mos u përsëritur as horizontalisht, as vertikalisht dhe as brenda katrorit të tyre. Në vend të numrave, ne kemi marrë shkronja të fjalëve të ndryshme nga feja jonë e bukur. Këtu kemi sudokun me katër shkronjat e fjalës Arshi. Kush më tregon çka është Arshi? Allahumme barik! Shumë bukur, Arshi është krijesa më e madhe që ka krijuar Allahu, mbi të cilën është Allahu. Filloni tani ta plotësoni atë. Të shikoj a janë përsëritur shkronjat.

- Allahu ju ruajttë dhe bëftë myslimanë të mirë! Esselamu alejkum!

Tregimet më të bukura

5. Lidh me shigjetë: Allahut:

na ka krijuar neve	mbi të Cilin s'ka gjë tjetër.
është më i Larti	pas të Cilit nuk mbetet asgjë.
është i Pari	që ta adhurojmë vetëm Atë pa i shoqëruar asgjë.
është i Fundit	është më afër krijesave me dijen e Tij se vetë ato.
është më i Afërti	para të Cilit s'ka pasur gjë tjetër.

6. Plotëso pesëvargëshin për Allahun. (emri, dy mbiemra - cilësia, tri folje - veprime, një fjali dhe sinonimi i emrit).

Allahu

i Pari i Pasuri

dëgjim flet qesh

Vetëm Allahun duhet adhuruar.

Allahu krijoi çdo gjë.

Zoti

I Pari, I Pasuri, I Gjithëdijshëm.
Dëgjon, Sheh, Flet, Qesh, Do, Gëzohet.
Vetëm Allahun duhet adhuruar.
Allahu krijoi çdo gjë.
Zoti. Err-Rrahmanu. Err-Rrahimu.

Tregimet më të bukura

7. Plotëso fjalëkryqin me disa nga krijesat e Allahut, të cilat ne i shohim!

Horizontal:

3. gjethet
5. hëna
6. lulet
7. dielli
9. kodrat
11. toka
13. shiu
14. qielli

Vertikal:

1. yjet
2. pemët
4. vullkani
7. deti
8. bari
10. retë
12. lumi

Tregimet më të bukura

8. Krijesat e Allahut me të cilat e plotësuam fjalëkryqin, i kemi në këtë peizazh të bukur. Gjeji ato duke shkruar numrin që kanë emrat e tyre te fjalëkryqi, si në shembull. Ngjyros!

9. Sudoku është një enigmë e cila ka për bazë gjetjen e numrave duke mos u përsëritur as horizontalisht, as vertikalisht dhe as brenda katrorit të tyre. Në vend të numrave, kemi marrë shkronjat e fjalës "ARSHI".

S	H	I	A	R
R	A	I	S	H
A	R	S	H	I
I	S	H	R	A

Mesazhet e mundshme të mësimdhënësit:

Dita e dytë:

Raportoni atëherë kur të kontrolloni detyrat që i kemi plotësuar dje në shkollë. Ndërsa kush nuk ka arritur t'i përfundoj dje, i plotëson ato sot. Gjithashtu na dërgoni foto të peizazhit që e keni ngjyrosur.

Dita e katërt:

Pas gjithë këtyre ushtrimeve e detyrave, të gjithë e kemi mësuar përmendsh tregimin e bukur për Allahun e Lartësuar. Raportoni atëherë kur ia recitoni atë përmendsh dhe bukur dikujt tjetër.

Dita e shtatë:

Elhamdulillah u bënë një muaj që nga fillimi i mësimi. Prandaj të përsërisim këto njohuri shumë të vlefshme që kemi mësuar deri tani për të vazhduar me mësim të reja, po ashtu shumë të rëndësishme. Si të bëhet kjo më lehtë e më efektive? Mënyra më e dashur dhe më përfituese në disa drejtime është mësimi në grup, së bashku gjithë familja. Varësisht prej numrit të anëtarëve të familjes, të ndahen rolet dhe mësimet. Përveç përfitimeve të dijes, pa diskutim kjo është dhe afërsi e dashuri mes familjes, për të cilën gjithashtu kemi shpërblime nëse bëhet për hir të Allahut.

Muaji tetor, java e parë


Mësimdhënësi:

- Muajin e kaluar kemi mësuar dhe përsëritur tregimin për Allahun. Sot do të vazhdojmë me një temë të re, e cila është për emrat e bukur të Allahut.
- Keni dëgjuar për emrat e Allahut, apo se sa emra ka Ai, apo shpërblimet për atë që i mëson emrat e Allahut? Hapni librin tek tema “Emrat e Allahut” dhe dëgjoni me vëmendje!

Pas leximit të mësimdhënësit, lexojnë të gjithë fëmijët nga një pjesë të këtij mësimi.

- Tani unë bëj pyetje dhe ju më përgjigjeni. A ka Allahu emra?
- Po, Allahu ka emrat më të bukur dhe më të përkryer. Që Allahu ka emra kemi argumente nga Kurani dhe hadithet profetike. A e dini çka është argumenti? Argument do të thotë arsyetim apo provë që sillet për të vërtetuar ose për të kundërshtuar diçka.
- Në rregull, kë kemi argument nga Kurani? E kemi ajetin 8 të sures Ta Ha.
- Po, nga hadithet kush është sjellë si argument që Allahu ka emra? Elhamdulillah për çdo gjë.

- Tek numri i emrave të Allahut çka na mësojnë dijetarët e fesë Islame?
- Cili emër është ofruar si emri i parë i Allahut?
- Çka do të thotë emri All-llahu? Po argument për këtë emër kush është?
- Këtë emër të Allahut do ta ngjyrosni në shtëpi, i cili është ushtrimi 10. Tek ushtrimi 11 e kemi një teknikë tjetër të mësimdhënies, e cila është “pema e mendimeve”. Këtu i kemi disa ndihmesa se si të plotësohet ajo, e cila bëhet sa më e plotë duke shtuar sa më shumë elemente për temën. Mund të degëzohet e nëndegëzohen të dhënat, të cilat i kemi marrë deri tani edhe nga tregimi edhe tek emrat e Allahut. Punë të mbarë!
- Kush do e lexoj “Pemën e mendimeve” për Allahun aq sa keni arritur të plotësoni? Në shtëpi do vazhdoni të plotësoni ende këtë ushtrim.
- Ushtrimi i fundit për sot është ushtrimi 12, ku thotë: Shkruani nga një fjalë që fillon me secilën shkronjë të emrit Allahut. Si çdo herë, të përpiqemi për të gjetur fjalë që kanë lidhje me fenë tonë. Çfarë fjale fillon me shkronjën e parë të emrit Allahut? Po me shkronjën LL çfarë fillon?
- Lexoni me radhë të gjithë fëmijët fjalët e zgjedhura!
- Allahu ua shtoftë të mirat të gjithëve! Esselamu alejkum!




Mesazhet e mundshme të mësimdhënësit:

Dita e dytë:

Si çdoherë në ditën pas ditës së mësimi, i kontrollojmë ushtrimet e plotësuar. Sot t'i kushtojmë më shumë kohë atyre, sepse do plotësojmë pemën e mendimeve tek ushtrimi 11. Pastaj më dërgoni fotografinë se si e keni përfunduar.

Dita e shtatë:

Dita më e dashur për ju, ku së bashku me familjen do përsërisni njohuritë e fituara. Prindërit ju pyesin dhe ju përgjigjeni.



Muaji tetor, java e dytë

Mësimdhënësi:

- Elhamdulillah kemi mësuar shumë gjëra deri tani. Ju lutem, kush dëshiron të përgjigjet (merr fjalën) ta ngrit vetëm dorën!

Bëhet përsëritje e shkurtër rreth njohurive të deritanishme duke inkadruar çdo fëmijë të grupit të flasë së paku një përgjigje.

- Kush është Zoti ynë? Ku është Allahu? Përse na ka krijuar Allahu? Si i bindemi ne Allahut? Çka ka krijuar Allahu? Çka është Arshi? Çka do të thotë adhurem? Po, hadithi çka është? Kush më tregon shkurtimisht për engjëjt dhe xhinët? Sa emra ka Allahu? Sa prej këtyre emrave nëse i mësojmë hyjmë në Xhenet? Njëri prej jush të thotë argumentin për emrat e Allahut nga Kurani dhe tjetri hadithin. Si është kuptimi i emrit Allahu?

- Elhamdulillah, Allahu ju begatoftë me të mira të dashur fëmijë! Sot do fillojmë me një mësim të ri, i cili është nga një lëndë tjetër e fesë, akideja apo në shqip: mësim – besimi. Ky mësim quhet: “Cili është urdhri më i rëndësishëm?” Pra, cili është urdhri më i rëndësishëm për të cilin na ka urdhëruar Allahu.

- Unë do lexoj dhe ju më përcillni.

Ndahet teksti në katër pjesë dhe kështu marrin pjesë të gjithë fëmijët në leximin e tij.

- Kush qenka urdhri më i rëndësishëm? Çka është teuhidi? Kush është argument për teuhidin?
- Në rregull, tani të plotësojmë ushtrimin 13, i cili na ndihmon të mbajmë mend më lehtë njërin prej argumenteve për teuhidin.
- Ushtrimi 14 na ndihmon për kuptimin e teuhidit. Tani lexojeni si e keni plotësuar këtë ushtrim.
- Shumë bukur, Allahumme barik! Takohemi për të mira! Esselamu alejkum!

Ushtrime

13. Gjei argumentin për teuhidin nga surja En-Nisa duke lidhur shkronjat tregje dhe duke mos përdorur të njëjtën shkronjë dy herë. Çdo fjalë ngjyose me ngjyra të ndryshme. Shkruaj ate në fund.

O	R	Ë	Q	U	D	H	A
N	I	S	H	O	R	O	N
T	A	I	S	O	M	I	
I	J	A	N	D	H	E	A
Ë	G	J	S	U	H	A	L
L							

Adhuremi Allahun dhe mos i shpëroni atij asgjë... (En-Nisa, 36)

Tregimet më të bukura

14. Zbulo fjalët e paraqitura pastaj plotëso vendet boshë me to, si në shembull.

Urdhri U R D H R I
Allahu A L L A H U
Vetëtim V E T E T I M
Mariton M A R I T O N
Teuhid T E U H I D
Gjërat G J E R A T
Besojmë B E S O J M E

Urdhri më i rëndësishëm është teuhidi. Pra, të urdhëruar Allahu, është teuhidi. Besojmë se besojmë bindshëm dhe të përdorim që Ai Allahu është i Vetëtim dhe i pa shok në gjërat që Ai imëriton dhe që vësohet me to.

Mesazhet e mundshme të mësimdhënësit në grupin e raportimeve:

Dita e tretë:

Do filloni të mbushni fletoren “Akideja” duke shkruar mësimin e parë “Cili është urdhri më i rëndësishëm?”. E dërgoni edhe foton me këtë detyrë.

Dita e katërt:

Mësimin nga akideja thuajse e dini pas ushtrimeve e shkrimit në fletore. Raportoni atëherë kur e keni mësuar përmendsh të gjithin.

Dita e pestë:

Ju vetë i përsërisni mësimet e ushtrimet e mësuara, **sepse siç kanë thënë dijetarët “Sëmundja e dijes është harresa, ndërsa ilaçi i saj është përsëritja.”** Mirëpo, sot kemi zgjedhur që të raportoni kur të përsërisni tregimin “Allahu i Lartësuar” së bashku me fjalët e panjohura të tij.

Dita e gjashtë:

Vazhdojmë me përsëritje të mësimëve duke raportuar atëherë kur gjatë përsëritjes së temës për emrat e Allahut dhe emrit All-llahu, ju i dini përmendsh ato.

Dita e shtatë:

Mësimin e akides që tashmë e dini përmendsh do e recitoni para anëtarëve të familjes. Po ashtu ata do iu parashtojnë disa pyetje për mësimet e mësuara deri tani dhe ju të përgjigjeni.

Muaji tetor, java e tretë

Mësimdhënësi:


- Allahu ju shpërbleftë me të mira për raportimet gjatë javës, ku kemi bërë edhe përsëritje. Sot do vazhdojmë me një mësim të ri nga lënda e hadithit. Ju të gjithë tashmë e dini hadithin me shtyllat e Islamit.
- Sa shtylla ka feja Islame?
- Unë e lexoj dhe ju përcillni me vëmendje, sepse pastaj do e recitoni përmendsh.
- Kur përmendet emri i Profetit duhet dërguar salavate, domethënë ai që e përmend thotë Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, dhe pas tij të gjithë thonë salAllahu alejhi ue selem.
- Elhmadulilah sot veçse e mësuat përmendsh këtë hadith. E kemi dhe ushtrimin 15 që është shumë i lehtë.
- Ndërsa tani do i përsërisim njohuritë që kemi mësuar deri tani përmes dy ushtrimeve të ofruara në faqen e fundit. Ju gjatë plotësimit të tyre nuk duhet shikuar në libër dhe as të konsultoheni me njëri tjetrin. Të fillojmë!

Ju vazhdimisht keni mësuar, përsëritur e kontrolluar mësimet e mësuara, mirëpo meqë përfundoi, elhamdulillah, gjithë libërthi, sot filloni nga fillimi shfletimin e këtij libërthi. Allahu ju dhëntë suksese! Amin!

Dita e familjes, ku së bashku do argëtoheni me njohuritë dhe ushtrimet e mësuara.

Mësimdhënësi:

- Elhamdulil-lahi Rabbil alemin, kemi përfunduar mësimet së bashku me ushtrimet për to të libërthit A. Na ka mbetur edhe diçka për të pa përfunduar. Cila është ajo? Ashtu është, na ka mbetur kopertina e tij.
- Këtu kërkohet të ilustrohet kopertina, përmes të cilës tregohet përmbajtja e libërthit. Pra, kur ua tregoni dikujt këtë libërth ai vetëm përmes kopertinës do ta dijë çka ka (gjendet) brenda tij. Për shembull do shkruani bukur e me ngjyra të ndryshme disa fjali nga tregimi për Allahun, apo pesëvargëshin që e keni plotësuar, apo sudokun, apo pemën e mendimeve. Po ashtu e shkruani emrin Allahu me shkronja të mëdha e ngjyra të bukura, kush di dhe mundet të shkruaj atë edhe me shkronja arabe. Çka na ka mbetur ende? Teuhidi, shumë bukur. Shkruani çka është teuhidi dhe argumentin për të, si dhe hadithin për shtyllat e Islamit. Unë mezi pres të shikoj sa bukur do ilustroni, sesi do bëheni ilustrues të zot.
- Shkëmbeni ngjyrat mes vete, kështu do merrni shpërblime, in shaa Allah, për ndihmën vëllait (motrës) tuaj.
- Shumë bukur, ma shaa Allah teberakAllah sa bukur keni ilustruar e sa ide të larmishme, të cilat tregojnë dhe dijen e juaj pasi nuk do të kishit pasur mundësi për një gjë të tillë nëse do iu mungonte dija, elhamdulilah.
- Kush nuk është i kënaqur me sa ka arritur, gjithashtu për të gjithë do këshilloja që të plotësoni ende në këtë ilustrim. Vetëm përfitime do keni asgjë tjetër.
- Allahu ju ruajttë dhe shtoftë dijen e dobishme! Esselamu alejkum!



Mesazhi i mësimdhënësit tek grupi i raportimit:

Dita e dytë:

Kontrollojeni punën e djeshme për kopertinën dhe plotësojeni ende me zbukurime e ushtrime. Kur e përfundoni atë na e dërgoni foton e saj në grup, o ilustrues librash. Allahu ju gëzoftë!

Dita e tretë:

Nga sot e katër ditët tjera të radhës keni detyrën e njëjtë: Lexim, së paku, 10 minuta në ditë nga libërthi A i librit “Tregimet më të bukura”.

Muaji nëntor, java e parë

Mësimdhënësi:

- Elhamdulillah kemi përfunduar një libërth të tërë (intonacioni rritet për t'ia bërë të ditur fëmijëve se kjo është shumë), ma shaa Allah. Të shoh pak kopertinat e ilustruara, edhe pse i kam parë të fotografuara dua t'i shikoj dhe kështu.
- Shumë shumë bukur, shkëlqyeshëm. Tani më tregoni: Kush është Zoti ynë? Ku është Allahu? Përse na ka krijuar Allahu? Si i bindemi ne Allahut? Çka ka krijuar Allahu? Çka është Arshi? Çka do të thotë adhurim? Po hadithi, çka është? Çka janë engjëjt dhe xhinët? Sa emra ka Allahu? (Allahu ka shumë emra, numrin e të cilëve nuk e di askush përveç Atij.) Sa prej këtyre emrave nëse i mësojmë hyjmë në Xhenet? (Dijetarët e fesë Islame na mësojnë që emrat e Allahut nuk janë vetëm 99 emra, mirëpo kush i mëson përmendsh 99 emra prej emrave të Allahut hynë në Xhenet.)
- Cili është ajeti që kemi marrë si argument për emrat e Allahut? Po hadithi cili është? Si është kuptimi i emrit Allahu? Cili është urdhri më i rëndësishëm? Çka është teuhidi? Kush është argument për të? Sa shtylla ka Islami?

Të gjithë fëmijët të marrin pjesë në përgjigje.

- Elhamdulillah, Allahu ju begatoftë me të mira të dashur fëmijë! Sot do fillojmë me një libërth të ri, libërthin e shkronjës? Po pra, shkronjës B. Më thoni disa fjalë nga feja jonë që fillojnë me këtë shkronjë. Besimi, besimtari, fjala bismil-lah. Ju lumtë!
- Tregimi titullohet “Besimtarët e shpellës”, keni ndonjë ide se kush janë këta besimtarë apo pse ceket shpella?
- Unë lexoj dhe ju më përcillni në libër. Kur unë ndaloj dhe kërkohet pyetje për atë pjesë ju me qetësi kërkoni fjalën!

Pas përfundimit të tregimit së bashku me pyetjet, vazhdohet me fjalët e panjohura për të. Pastaj ndahet teksti në atë mënyrë sa të marrin pjesë të gjithë fëmijët në lexim të tij.

- Allahu ju shpërbleftë me të mira! Esselamu alejkum dhe vazhdoni kështu të rregullt në raportimet e javës!

Mesazhi i mësimdhënësit:

Dita e dytë:

Sot do lexoni tregimin “Besimtarët e shpellës” dhe fjalët e panjohura të tij.

Dita e tretë:

Pyetjeve të mësimit iu kemi përgjigjur në shkollë. Sot do i shkruani në fletore me fjali të plota dhe me bukurshkrim. Na ka mësuar Profeti (salAllahu alejhi ue selem) që: **“Allahu është i Bukuri dhe e do të bukurën.”** Pastaj i dërgoni fotot e tyre në grup, kështu kam kohë më shumë për t’i kontrolluar dhe për të dhënë sugjerimet për to.

Muaji nëntor, java e dytë

Mësimdhënësi:

- Allahu ju dashtë e gëzoftë fëmijë të dashur! Lexo (i drejtohet fëmijës së caktuar) pyetjen e parë! Në rregull, tani lexo (i drejtohet fëmijës tjetër) përgjigjen e kësaj pyetje!

Kështu vazhdohet me të gjitha pyetjet dhe përgjigjet që kanë shkruar në fletore.

- Në rregull, tani hapni librat tek ushtrimi 1 i libërthit B. Thuhet: “Rendit fjalitë për tregimin “Besimtarët e shpellës” sipas vijueshmërisë së tij.” Lexoni secili për vete këto fjali, pastaj shkruani numrin 1 te fjalia që duhet të jetë e para, pastaj 2 e kështu me radhë deri te 9. I gjetët renditjen e fjalive? Të lexojmë tani sipas renditjes që duhet të ketë.

Secilën fjali e lexon nga një fëmijë.

- Te ushtrimi 2 kemi një fjalëkryq. Shkruani emrin e figurës në rreshtin përkatës. Kujdes! Emri të shkruhet në të pashquarën. E plotësuar? Elhamdulillah saktë. Tani të shikojmë a formojnë ndonjë fjalë këto shkronjat horizontalisht? Çfarë është shkruar? Çka dini ju për kuptimin e besimtarit?

- Me kuptimin e tij do plotësojmë ushtrimin 3.

- Ushtrimi 4 është pesëvargëshi. Si plotësohet pesëvargëshi? Pra emri i tij është *Besimtari*. Në rendin e dytë duhet dy mbiemra, pra dy fjalë që tregojnë si është ai. Pastaj janë tri folje, që i bie: tri fjalë çfarë bënë një besimtar. Në rendin e katërt e shkruan një fjali për besimtarin. Dhe në të fundit sinonim për besimtarin, pra si mundemi ta quajmë ndryshe atë? Tani të lexojmë me radhë si e keni plotësuar këtë pesëvargësh.

- Ushtrimi 5 ka fjalën *Besimtari* në mes dhe anash saj disa fjali. Ato fjali që i përshtaten një besimtari e lidhni me shigjetë, ndërsa ato që nuk duhet t'i ketë ai i lini ashtu. Të lexojmë së pari cilat cilësi nga ky ushtrim i takojnë besimtarit. Pastaj cilat cilësi nuk i përshtaten një besimtari.

- Ju i keni shkruar dhe lexuar kuptimet e fjalëve të panjohura. Tani te ushtrimi numër 6 do i lidhni katër prej tyre. Lexo cila fjalë e ka kuptimin e fjalisë së parë. Pastaj të dytës e kështu me radhë.

- Allahu ju dhëntë mirësi të panumërta fëmijë të dashur! Amin! Takohemi këto gjashtë ditët e ardhshme në grupin e raportimit. Nga Allahu kërkojmë ndihmë dhe sukses!

Ushtrime

1. Rendit fjalitë për tregimin "Besimtarët e shpellës" sipas vijueshmërisë së tij.

- Disa djem të rinj besimtarë u fshehën në një shpellë.
- Shumë kohë më parë jetonte një popull.
- Allahu i Madhëruar i bëri të flenë ata për treqind e nëntë vjet.
- Mbreti i tyre i detyronte të gjithë të adhuronin idhujt.
- Kur i zgjoi Allahu, ata menjëherë e kujtuan Atë.
- Ata iu lutën Allahut me bindje të plotë për t'ua ruajtur besimin.
- Mirëpo banorët e qytetit ishin bërë besimtarë dhe mbreti i tyre ishte i urtë e i devotshëm.
- Përkundër kujdesit për të mos i njohur, Allahu bëri që ata të zbulohen.
- Pastaj njëri prej tyre shkoi në qytet për të blerë ushqim.

3. Fjalën që zbulohet në fjalëkryq shkruajpërkohë që shprehim mendimin e tij duke u ndihmuar me përshkrimin të fjalës së panjohura në të cilën ajo është përfshirë.

Tregimet më të bukura

2. Përkohë fjalëkryqin (fjalët në të pashkëputur) nga shkronjat e përshkruara për çfarë është shkruar dhe jepi çfarë di për të.

Tregimet më të bukura

1. Përkohë fjalëkryqin për Besimtarin.

Shkruaj:

1. Dy fjalë që tregojnë se është ai.

2. Tri fjalë që janë bërë një besimtar.

3. Një fjalë që është bërë për të.

4. Si mundet ta kualifikojmë njerëzit?

5. Në u ndihmëm me disa cilësi që duhet të ketë besimtar. Shpreh me ato cilësi që i shpreh ai.

6. Lidh me shigjetë shprehimin me fjalën përkatëse.

Tregimet më të bukura

Besimtari

1. Përkohë fjalëkryqin për Besimtarin.

Shkruaj:

1. Dy fjalë që tregojnë se është ai.

2. Tri fjalë që janë bërë një besimtar.

3. Një fjalë që është bërë për të.

4. Si mundet ta kualifikojmë njerëzit?

5. Në u ndihmëm me disa cilësi që duhet të ketë besimtar. Shpreh me ato cilësi që i shpreh ai.

6. Lidh me shigjetë shprehimin me fjalën përkatëse.

BESIMTARI

- sa herë flet gënjën
- i lutet vetëm Allahut.
- fai namaz
- nuk e ndjekë Muhamedin

6. Lidh me shigjetë shprehimin me fjalën përkatëse.

Besimtarë

Që i përmbahet fesë së Allahut me përpikëri.

Mosbinda ndaj Allahut dhe profetit Muhamedit (sallallahu alejhi ue salem).

Njerëzit të cilët i besojnë Allahut dhe të Dërguarit, Muhamedit (sallallahu alejhi ue salem) dhe i takojnë atij.

Cdo gjë që adhurohet përveç Allahut dhe ka formë të caktuar.

Mesazhet e mundshme të mësimdhënësit në grupin e raportimeve:

Dita e tretë e kësaj jave:

Së pari do ta lexoni tregimin e bukur "Besimtarët e shpellës". Pastaj do i shkruani fjalët e panjohura të tij. Si zakonisht detyrat që shkruhen i fotografoni dhe dërgoni ato për t'i kontrolluar unë.

Elhamdulillah e lexova tregimin e bukur "Besimtarët e shpellës" dhe i kam shkruar fjalët e panjohura.

Dita e katërt e kësaj jave:

Kontrolloni dhe lexoni fjalët e panjohura të dy tregimeve që janë shkruar në fletore.

Dita e pestë e kësaj jave:

Sot do përsërisni fjalët e panjohura të dy tregimeve. Por si do i përsërisni? Ndonjë familjar i juaji ua pyet ato dhe ju përgjigjeni.

Dita e gjashtë e kësaj jave:

Sot do përsërisni mësimet e këtij libërthi, si: tregimin, fjalët e panjohura dhe ushtrimet e plotësuara të cilat na ndihmojnë për të mbajtur në mend ato. Këto përsëritje preferohen të bëhen së bashku me familjen.

Dita e shtatë e kësaj jave:

Nesër kemi mësim në shkollë, elhamdulillah. Me radhë është lënda e emrave të Allahut. Prandaj përsërisni me vëmendje mësimin e kaluar për emrat e Allahut.

Muaji nëntor, java e tretë

Mësimdhënësi:

- Cili është argumenti që e vërteton se Allahu ka emrat më të bukur? Sa emra ka Allahu? Kush e thotë hadithin, i cili është argument për emrat e Allahut? Prej nga janë nxjerrë emrat e Allahut, pra dijetarët ku i kanë lexuar emrat e Allahut? Emrat e Allahut janë nxjerrë nga dy bazat e fesë sonë, nga Kurani dhe suneti profetik (hadithet).

- Cilin emër të Allahut e kemi mësuar? Si është kuptimi i tij? Po argumenti? Ma shaa Allah, Allahu ua shtoftë dijen e hajrit!

- Sot do i mësojmë dy emra prej emrave të Allahut. Si çdoherë unë lexoj dhe ju më përcillni.

- Tani, kështu me radhë do lexojmë të gjithë këta emra. (Mund të ndahet teksti: një fëmijë lexon kuptimin e emrit dhe tjetri argumentin për të).

- Vazhdimisht nëpër ushtrime e mësimet do i përsërisim emrat e Allahut që i mësojmë në mënyrë që të nguliten në mendjen tuaj të njomë sa më mirë. Po ashtu kjo metodë do ua zhvilloj edhe kujtesën e logjikën tuaj.


- Në rregull, fillojmë me ushtrimet. Ushtrimi i parë për këtë lëndë dhe i shtati për këtë libërth thotë: “Ndaj fjalët me vizë, pastaj shkruaj fjalinë me bukurshkrim.” Këtu janë shumë shkronja të ngjitura së bashku, ju do i ndani ato vetëm kur formohet fjalë kuptimplotë. Cila është fjala e parë? Janë shkronjat: “Zotiynë”, sa fjalë janë këtu dhe cilat? Shumë bukur, plotësojeni të gjithë ushtrimin. Mirë, lexoje ... (dy – tre fëmijë).

- Vazhdon ende ky ushtrim, i cili thotë: “Çka tregon kjo fjali?” Elhamdulillah, pra është argumenti për emrin e Allahut, Err-Rrabhu, që në gjuhën shqipe përshtatet si? Shumë bukur, Err-Rrabhu në gjuhën shqipe përshtatet me Zoti.

- Ushtrimi 8: “Ngjyros dy emrat e Allahut që i mësuam.” Këtë ushtrim e vazhdoni në shtëpi kush nuk ka arritur të përfundoj.

- Ushtrimi 9. “Gjej vendin e tre emrave të Allahut për të shkruar aty ata në gjuhën arabe.” Në këtë ushtrim u bënë bashkë tre emrat e mësuar. Përcilleni vijën e emrit përkatës deri në fund të saj ku dhe do e shkruani atë emër në gjuhën arabe. Më e qartë dhe më bukur do duket nëse këtë e bëni me tri ngjyra për secilin emër.

- Allahu ju shpërbleftë me të mira! Esselamu alejkum!





Muaji nëntor, java e katërt

Mësimdhënësi:

- Cili është urdhri më i rëndësishëm për të cilin na ka urdhëruar Allahu? Çka do të thotë teuhid? Argumentin e parë, kush e thotë? Po të dytin? Ma shaa Allah! Allahu ju nderoftë e dashtë!
- Çka është gjynahu apo mëkati?
- Shumë bukur, dhe sot do mësojmë për gjynahun më të madh, të cilin Allahu nuk e falë. Pra “Cila është e keqja më e madhe?” Dëgjoni me vëmendje duke e përcjellë mësimin që e lexoj.

Lexojnë të gjithë fëmijët tekstin e ndarë së paku në tri pjesë.

- Ne u njoftuam me dy mësim nga mësim-besimi (akideja): 1. Teuhidin - urdhrin më të rëndësishëm dhe 2. Shirkun - e keqja, gjynahu më i madh. Si zakonisht, në libër kemi ushtrime të ndryshme për të na lehtësuar të kuptuarit e mësimëve.
- Tani tek ushtrimi 10 janë bërë bashkë këto dy mësim të cilat ne me lehtësi i ndajmë ato.
- Sot do zbërtheni vetëm mësimin e parë, për teuhidin dhe në shtëpi vazhdoni me shirkun.
- Ushtrimi 11 është i ngjashëm me ushtrimin 13 të libërthit A, vetëm se këtu mbesin ende shkronja me të cilat formohet një fjali me kuptim, elhamdulillah.
- Tek ushtrimi 11 e gjetëm përmes lojës argumentin e parë për shirkun, ndërsa tek ushtrimi 12 do e plotësojmë argumentin e dytë për të, hadithin.
- Allahu ju shpërbleftë me të mira! Esselamu alejkum!



Ushtrime

10. Zbërthe dy mësimet e mësuara nga akideja duke i shkruar te dyja.

Urdhri më ¹teuhidi. Pra ²për të cilin ³i rëndësishëm ⁴ë besojmë

na ka urdhëruar ⁵bindshëm dhe të ⁶Allahu, është ⁷pranojmë se

⁸Allahu është ⁹pa shok në ¹⁰Vetëm e i ¹¹meriton dhe

¹²që veçohet ¹³gjërat që Ai ¹⁴me to. ¹⁵

¹E keqja ²që është bëria shirk ³është e kundërta ⁴më e madhe

⁵(shok, ortak) Allahut të ⁶e teuhidit, e ⁷ndaj Tij. ⁸Lartësuar në adhurimin

⁹ta adhurosh ¹⁰Shirku është ¹¹dikë tjetër ¹²apo bashkë ¹³përveç Allahut ¹⁴me Të.

Cili është urdhri më i rëndësishëm?

Urdhri më i rëndësishëm për të cilin na ka urdhëruar Allahu, është teuhidi. Pra, të besojmë bindshëm dhe të pranojmë se Allahu është i Vetëm e i pa shok në gjërat që i meritojmë dhe që veçohet me to.

Cila është e keqja më e madhe?

E keqja më e madhe është e kundërta e teuhidit, e që është bëria shirk (shok, ortak) Allahut të Lartësuar në adhurimin ndaj Tij. Shirku është ta adhurosh diçka tjetër përveç Allahut apo bashkë me Të.

Muaji dhjetor, java e parë

Mësimdhënësi:

- Allahu ju shpërbleftë me të mira për punën me përkushtim! Sot do vazhdojmë me një hadith të ri, të cilin gjithashtu shumica veçse e keni mësuar sa keni qenë të vegjël.
- Unë e lexoj dhe ju përcillni me vëmendje se pastaj disa do e recitoni përmendsh.
- Elhmadulilah! Ushtrimi 13: "Shkruaj bukur fjalët brenda katrorit. Lidh përmes shigjetës me vendin përkatës në hadith. Plotëso." Pra, së pari i gjeni këto fjalët se cilat janë brenda katrorit. Cila është kjo fjala e parë që duken shkronjat P pastaj një r, o, f? Shumë bukur është Profetët. Tek cili rresht duhet shkruar, cilën renditje ka në hadith? Tek rreshti 4 ku shkruan: "që Ai dërgoi". Kush i dërgoi profetët? Ma shaa Allah, Allahu i dërgoi profetët tek njerëzit.
- Ushtrimi 14: "Sudoku me fjalën "IMAN". Çka është imani? Imani është besimi që i mësuam bazat e tij. Ndërsa ushtrimi 15: "Plotëso trungun me degët të cilat i takojnë." Në formë të degëve i shkruani shtyllat e Islamit dhe tek trungu i imanit shkruani bazat e tij. Këto dy ushtrime i plotësoni në shtëpi.
- Ndërsa tani do i përsërisim njohuritë e reja të libërthit B përmes dy ushtrimeve të ofruara në faqen e fundit. Ju gjatë plotësimit të tyre nuk duhet shikuar në libër dhe as të konsultoheni me njëri-tjetrin. Të fillojmë!

Tregimet më të bukura

11. Përshkoje labirintin duke ngjyrosur nëpër shkronjat fjinje pa i tejkaluar apo përsëritur ato për të vazhduar fjalinë e dhënë. Shkruaje në fund kërkesën e gjetur. Pastaj rikthehesh nga fillimi ku me shkronjat e mbetura zbulon një mësim të rëndësishëm. Shkruaje.

Argumenti për shirkun është:

E	k	f	a	.	i	b
V	e	k	i	t	h	ë
q	j	a	ë	n	u	q
m	ë	t	r	u	h	e
t	t	e	t	l	a	d
ë	j	ë	ë	A	a	k
d	u	k	i	sh	t	e
o	j	t	a	ë	t	a
sh	ë	i	f	a	j	e
r	k	i	a	r	u	ë

"Vertetë Allahu nuk fal! që t'i bëhet Atij shirk, ndërsa mekatet tjera ia fal kupt të doje." (En-Nisa, 48)

Me shkronjat e mbetura: *E keqja më e madhe është shirku.*

Tregimet më të bukura

12. Plotëso shkronjat në tabelën e dytë nga tabela e parë. Zbulon përgjigjen e Profetit (salAllahu alejhi ue selem). Pastaj shkruaje në fund në vendin e zbrazët te hadithi.

A	T	Ë	H	E	B	Ë	S	H	R	A
M	E	D	I	K	Ë	S	E	T	Ë	
B	A	R	A	B	A	R	T	Ë	E	
A	M	E	Ë	A	L	L	A	H	U	N
E	D	N	D	Ë	R	K	O	H	Ë	
J	A	Q	Ë	N	Ë	A	I	I	A	
T	Ë	K	A	K	A	S	I	K	U	
N	E	K	R	I	J	U	A	R	Ë	

	T	Ë			B	Ë	S	H		
			D	I	K	Ë			T	Ë
B	A	R	A	B	A	R	T	Ë		
	M	E			A	L	L	A	H	U
			N	D	Ë	R	K	O	H	Ë
			Q	Ë			A	I		
T	Ë				K	A				
					K	R	I	J	U	A

"Është pyetur Muhamedi (salAllahu alejhi ue selem): "Cili është mekati më i madh?" Ka thënë: "Të bësh dikë të barabartë me Allahun ndërkohë." (Buhariu dhe Muslimi)

që Ai të ka krijuar."

- Allahu ju gëzoftë e shtoftë të mirat për punën! Kështu kemi përfunduar libërthin e dytë me shkronjën B. A na ka mbetur diçka tjetër në këtë libërth pa plotësuar?

- Na ka mbetur edhe ilustrimi i kopertinës. Si duhet ilustruar ajo, ju kujtohet? Këtë punë do ta punoni në shtëpi dhe na fotografoni ato për t'i parë më mirë e më herët (para ardhjes në shkollë sot një javë).

- Allahu ju ruajttë dhe shtoftë dijen e dobishme! Esselamu alejkum!

Ushtrime

13. Shkruaj bukur fjalët brenda katrorit. Lidh përmes shigjetës me vendin përkatës në hadith. Plotëso.

1. Të besosh Allahun.
2. Engjëjt e Tij,
3. Librat që Ai zbriti,
4. Profetët që Ai dërgoi,
5. Ditën e Fundit,
6. Kadër qoftë i mirë apo i keq.

Tregimet më të bukura

14. Sudoku me fjalën "IMAN"

I	M	A	N
A	N	M	I
M	I	N	A
N	A	I	M

15. Plotëso tringun me degët të cilat i takojnë.

Tregimet më të bukura

Të përsërisim njohuritë e reja të këtij libërthi.

A. RRETHO PËRGJIGJEN E SAKTË.

- 1) Ku u strehuan djemtë e rinj?
 - a) në pyll.
 - b) në një shpellë.**
 - c) në shtëpitë e tyre.
- 2) Sa vite fjetën djemtë e rinj?
 - a) njëqind vite.
 - b) dyzet vjet.
 - c) treqind e nëntë vjet.**
- 3) Pse u fshehën djemtë e rinj në shpellë?
 - a) Për të ruajtur besimin e tyre.**
 - b) Për të pushuar nga udhëtimi.
 - c) Për të biseduar mes vete.
- 4) Çfarë ndodhi me ta kur Allahu i zgjoi?
 - a) planifikuan si t'i vizitonin familjarët.
 - b) u zbuluan nga populli.**
 - c) vazhduan të fshihehin çdo herë.
- 5) Si ishte gjendja në vendin e tyre?
 - a) praktikohej besimi i saktë.**
 - b) mbreti i vjetër ende ishte gjallë.
 - c) ishte vend i pabanueshëm.
- 6) Cila kafshë ishte me djemtë e rinj?
 - a) macja.
 - b) qeni.**
 - c) qengji.

B. Shkruaj saktë apo gabim në fjalitë e dhëna.

- 1) Besimtarë quhen njerëzit të cilët i besojnë Allahut dhe të Dërguarit, Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem) dhe çdo gjë që na ka treguar Ai dhe i Dërguari. **saktë**
- 2) Emri i Allahut Err-Rabbu në gjuhën shqipe do të thotë "i Adhuruari". **gabim**
- 3) Idhulli është çdo gjë që adhurohet përveç Allahut dhe ka formë të caktuar i ka dhënë formë njeriu. **saktë**
- 4) Mëkat është veprimi i asaj që e ka ndaluar Allahu ose mosveprimi i asaj që ka urdhëruar të veprohet. **saktë**
- 5) Kuptimi i emrit të Allahut Err-Rabbu është: Allahu është i Vetmi që meriton të adhurohet. **gabim**
- 6) Kuptimi i emrit të Allahut El-Ilahu është: Allahu është i Vetmi që meriton të adhurohet. **saktë**
- 7) Emri i Allahut El-Ilahu në gjuhën shqipe do të thotë "Zoti". **gabim**
- 8) Shirku është ta adhurosh dikë tjetër përveç Allahut apo bashkë me Të. **saktë**

Tregimet më të bukura

Bëhu ilustrues i kopertinës, e cila tregon përmbajtjen e këtij libërthi!

Mesazhet e mundshme të mësimdhënësit në grupin e raportimeve:

Dita e pestë

Në fletoren “Tregimet më të bukura” i shkruani dy ushtrimet e faqes së fundit. Nga ushtrimi A e shkruani pyetjen dhe i përgjigjeni asaj me fjali të plotë. Për shembull, pyetja 1: Ku u strehuan djemtë e rinj? Përgjigjja: Djemtë e rinj u strehuan në një shpellë.

Ushtrimin B shkruani sikur për libërthin A, pra 8 fjalitë i shkruani në formën e saktë të gjitha.

Muaji dhjetor, java e dytë

Mësimdhënësi:

- Ne këtu çdoherë kënaqemi duke mësuar për Allahun dhe fenë tonë, mirëpo sot nuk do na duhen as librat e as fletoret. Do luajmë në grupe duke vizatuar e punuar punime me të cilat do i zbukurojmë muret e shkollës sonë. Këto punime të vendosura në mur do na ndihmojnë të kujtojmë më lehtë mësimet që janë në to.
- Janë dy grupe (dy punime duke ndërruar grupet fëmijët):
 - Grupi i parë do punojë “pemën e mendimeve” vetëm për krijesat e Allahut. Pra, në mes shkruani “Allahu krijoi çdo gjë”. Kjo degëzohet në dy degë: “ato që shihen” dhe “ato që nuk shihen”. Tek dega “nuk shihen” kemi vetëm dy lloj të krijesave, ndërsa tek “ato që shihen” degëzoni e nëndegëzoni, mund dhe t’i vizatoni disa prej tyre që nuk kanë shpirt. p.sh. degë “kafshët”, nëndegë e saj: 1) kafshë të egra dhe 2) kafshë shtëpiake. Pastaj nëndegë të këtyre kafshëve etj.
 - Grupi i dytë do përgatit punimin për emrat e Allahut. Ne kemi mësuar tre emra deri tani, mirëpo ju do shkruani nën titullin “EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT” edhe dy argumentet (ajetin 8 të sure “Ta Ha” dhe hadithin që e transmeton Buhariu). Pastaj në katrorët e vegjël do ngjiten emrat që do mësojmë me radhë, të cilët do i shkruani e zbukuroni në fleta me ngjyra. Çdo emër të ri që mësojmë, ju të ndarë në grupe do e zbukuroni emrin e mësuar të Allahut dhe pastaj vendoset në këtë punim.



Muaji dhjetor, java e tretë

Mësimdhënësi:

- Elhamdulillah kemi përfunduar edhe libërthin e dytë, tebarakAllah. Sot do vazhdojmë me libërthin e tretë, me shkronjën C. Këtë libërth e fillojmë duke mësuar për njerëzit më të mirë dhe cilësitë, sjelljet e tyre me të cilat synojmë t'i përvetësojmë edhe ne. Allahu e mundësoftë këtë!

- Pra tregimi quhet: “Cilësitë e profetëve”. Unë lexoj, ju përcjellni atë dhe kur bëj pyetje ju përgjigjeni.

Pas përfundimit të tregimit së bashku me pyetjet, vazhdohet me fjalët e panjohura për të. Pastaj ndahet teksti në atë mënyrë sa të marrin pjesë të gjithë fëmijët në lexim të tij.

- Allahu ju dhëntë suksese të vazhdueshme dhe na bashkoftë në të mira! Esselamu alejkum!

Muaji dhjetor, java e katërt

Mësimdhënësi zgjedh disa nga pyetjet e tregimit për t'iu përgjigjur fëmijët.

- Mësuam disa nga emrat e profetëve me disa nga cilësitë e tyre.

- Ushtrimi 1, na kërkon dy prej profetëve të mësuar.

- Ushtrimi 2, kemi një enigmë shumë të lehtë me emrat e profetëve të përmendur në tregim.

- Ushtrimi 3, është pema e mendimeve për temën e këtij libërthi.

- Ushtrimi 4: “Këto fjali tregojnë për njërin nga profetët e Allahut. Gjeje cili është ai, shkruaje emrin e tij dhe formulo një pesëvargësh për të nga këto fjali.”

- Ushtrimi 5: “Gjej katërmëdhjetë herë fjalën "Profet", duke lexuar horizontalisht djathtas - majtas dhe majtas - djathtas, dhe vertikalisht, lartë - poshtë dhe poshtë - lartë.” Pra ky ushtrim është sikur ushtrimi 2, vetëm se këtu duhet lexuar në katër drejtime, mos u ngutni. Shikoni me kujdes është shumë e lehtë, por dobia e saj është zhvillimi i mprehtësisë së vëmendjes.

- Kush nuk ka arritur deri tani të përfundojë ushtrimin 5 le ta vazhdojë atë në shtëpi.

- Dhe ushtrimi i fundit për sot është fjalëkryqi, të cilin ju shumë e doni. Ju kujtohet tregimi “Cilësitë e profetëve”? Kemi shtatë cilësi të profetëve për t'i gjetur emrat e tyre që i kemi lexuar në tregim.

- Në rregull, Allahu ju dhëntë mirësi të panumërta vazhdimisht! Esselamu alejkum!

Muaji janar, java e parë

Mësimdhënësi:

- Tashmë i kemi mësuar tre emra të Allahut. Cilët janë ata? Si e ka kuptimin në gjuhën shqipe emri All-llahu? Po emri El-llahu? Emri Err-Rrabu? Përgjigje e saktë, barakAllahu fik! Tani njëri fëmijë e thotë emrin e Allahut në gjuhën shqipe, ndërsa fëmija tjetër në gjuhën arabe. Ju lumtë!

- Këtyre tre emrave sot do ua shtojmë edhe dy emra të ri. Këta emra i themi shumë shpesh gjatë ditës, si në namaz duke e recituar suren El-Fatiha gjithashtu në besmelen edhe për raste të tjera. E dini për cilët emra bëhet fjalë? Pra, për emrat e Allahut Err-Rrahmanu dhe Err-Rrahimu. Unë do të lexojë tekstin për ta dhe ju përcjelleni atë.

Pas leximit të mësimdhënësit, lexojnë me radhë të gjithë fëmijët.

- Ushtrimi 7, kërkon ngjyrosjen e tyre, ku fëmijët së bashku mësojnë si duken këta emra dhe kënaqen duke ngjyrosur.

- Ushtrimi 8 është shumë ushtrim i bukur. Ato shkronjat e shpërndara lidhni për të gjetur emrat e tetë profetëve që kemi cekur në tregim, pastaj shkronjat e rrethuara shkruani në të djathtë vertikalisht. Cilin emër të Allahut zbuluat?

- Ushtrimi 9. Kemi pesë emrat e Allahut që i kemi mësuar në të tri format: emrin e Allahut në gjuhën arabe me shkronja latine e shkronja arabe, dhe atë të përshtatur në gjuhën shqipe. Ju do i lidhni këto tri forma të pesë emrave të Allahut dhe pastaj i shkruani ata poshtë, është edhe shembulli për emrin e parë si të plotësohet. Elhamdulillah!

- Shihemi javën e ardhshme! Esselamu alejkum!

Mesazhet e mundshme të mësimdhënësit në grupin e raportimeve:

Dita e tretë e kësaj jave:

Sot do të lexoni disa herë me vëmendje dy emrat e ri të Allahut.

Elhamdulillah i lexova (numrin e leximit) herë tekstin për dy emrat e Allahut: Err-Rrahmanu dhe Err-Rrahimu.

Dita e katërt e kësaj jave:

Në fletoren “Emrat e bukur të Allahut” shkruani dy emrat e ri të mësuar.

Elhamdulillah i kam shkruar emrat e Allahut: Err-Rrahmanu dhe Err-Rrahimu në fletore.

Dita e gjashtë e kësaj jave:

Pesë emrat e bukur të Allahut që veçse i keni mësuar përmendsh do ua recitoni, pse jo edhe ua mësoni, ndonjërit prej anëtarëve të familjes apo ndonjë shoku/shoqe.

Muaji janar, java e dytë

Mësimdhënësi:

- Cili është urdhri më i rëndësishëm për të cilin na ka urdhëruar Allahu? Çka do të thotë teuhid? Argumentin e parë, kush e thotë? Po të dytin? Ma shaa Allah!
- Çka është gjynahu apo mëkati? Shumë bukur, cila është e keqja më e madhe? Çka është shirku? Sa argumente kemi marrë për shirkun? Kush e thotë argumentin nga Kurani? Cili është argumenti nga suneti?
- Mësimi i ri nga akideja është: “Përse Allahu i dërgoi profetët?”. Dëgjoni me vëmendje!
- Kështu si jeni ulur do lexoni nga dy fëmijë këtë mësim, i pari përgjigjen e pyetjes, ndërsa i dyti argumentin për të.
- Me radhë është ushtrimi 10, i cili na përkujton të tri mësimet nga akideja së bashku me argumentet e tyre. Kush e merr fjalën për të lexuar, së pari e lexon pyetjen së bashku me të tri opsionet e ofruara, pastaj thotë: “Përgjigjja e saktë është nën a, apo cila është”. Në rregull? Fillojmë.
- Tek ushtrimi 11 kemi labirint me tri mësimet e kësaj lënde mësimore.
- Allahu ju gëzoftë! Esselamu alejkum!

Muaji janar, java e tretë

Mësimdhënësi:

- Erdhëm tek fundi i libërthit të tretë, ma shaa Allah. Sa shumë e sa shpejt po mësojmë. Kush e thotë hadithin “Shtyllat e Islamit”? Tani hadithin e dytë, “Bazat e Imanit”?
- Hadithi i tretë me radhë është ..., dëgjoni me vëmendje duke më përcjellur.

Lexojnë dy-tre fëmijë, derisa të tjerët që e kanë mësuar atë përmendsh e recitojnë para klasës/grupit.

- Ushtrimi 12: “Rendit fjalët për të formuar tri hadithet saktë. Shkruaj ato.”
- Të shikoj a e keni shkruar renditjen drejt. Elhamdulillah, shkëlqyeshëm.
- Tani është faqja e fundit. Në raportime keni bërë përsëritjen e njohurive të këtij libërthi, prandaj do ta keni shumë të lehtë plotësimin e saj. Si zakonisht gjatë plotësimit të faqes së fundit nuk duhet të komunikoni mes vete, përqendrohuni në plotësimin e faqes suaj sa më mirë.
- Allahu ju shpërbleftë me të mira! Ilustrimin e kopertinës ta bëni sa më të plotë në shtëpi, sepse tani edhe jeni rritur si për nga mosha edhe për nga dija e përvoja. Esselamu alejkum!

Muaji janar, java e katërt

Mësimdhënësi:

- Tashmë jemi njoftuar, mësuar, ushtruar e përsëritur tre libërtha, secili prej tyre ka nga trembëdhjetë faqe, dhe për këtë gjithë falënderimi i takon Allahut të Lartësuar, elhamdulillah. Allahu na dhëntë suksese të vazhdueshme!

- Sot do përsërisim njohuritë e këtyre tre libërthave dhe njëkohësisht të parapërgatitemi për një “Kontrollim njohurish” me shkrim. Kjo do të jetë sikur faqet e fundit të libërthave që i plotësonit, vetëm se fletët ua sjellë unë dhe nuk janë në libër.

- Mund t'i shkoj në mend dikujt se pse të bëjmë edhe këtë formë të përsëritjes, kur ne vazhdimisht përsërisim e përsërisim? Përgjigjja: përdorim forma të ndryshme të mësimave, ushtrimeve e përsëritjeve vetëm e vetëm për t'ua bërë juve, fëmijë të dashur (zgjuar), sa më të lehtë të kuptuarit dhe mbajtjen në mend të këtyre njohurive bazike, elementare. Të gjithë harrojnë, është ligj i Allahut. Por cila është formula për të zgjidhur problemin e harresës? Është përsëritja. Kush më thotë fjalën e dijetarëve për këtë? “Sëmundja e dijes është harresa, ndërsa ilaçi i saj është përsëritja.” Profeti salAllahu alejhi ue selem e ka përsëritur Kuranin edhe pse i është shpallur atij, kjo edhe për të na mësuar neve, sepse ai, salAllahu alejhi ue selem është shëmbëlltë e duhet ndjekur.

- Mbani mend këtë gjithmonë: “Kur i përgjigjeni pyetjeve, çdoherë ato i formuloni me fjali të plotë”. Të fillojmë?

- Pyetjet që ua lexoj tani, ju iu përgjigjeni gojarisht, mirëpo sot një javë do i shkruani ato.

- Kush është Zoti ynë? Ku është Allahu? Përse na ka krijuar Allahu? Çka është adhurimi? Sa vite fjetën djemtë e rinj? Pse u fshehën djemtë e rinj në shpellë? Kush quhet besimtarë? Kush janë profetët? Kur i dërgoi Allahu profetët te njerëzit? Cili është obligimi ynë ndaj profetëve?

- Allahumme barik, ma shaa Allah. Tani unë lexoj kuptimin e fjalës, ndërsa ju e gjeni për kë bëhet fjalë.

- quhen njerëzit të cilët i besojnë Allahut dhe të Dërguarit, Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem) dhe çdo gjë që na ka treguar Ai dhe i Dërguari i Tij.

- është çdo vepër dhe fjalë që e do Allahu dhe është i kënaqur me të, qoftë e jashtme apo e brendshme.

- është ta adhurosh dikë tjetër përveç Allahut apo bashkë me Të.

- është çdo gjë që adhurohet përveç Allahut dhe ka formë të caktuar, i ka dhënë formë njeriu.

- do të thotë të besojmë bindshëm dhe të pranojmë se Allahu është i Vetëm e i pa shoq në gjërat që Ai i meriton dhe që veçohet me to.

- është veprimi i asaj që e ka ndaluar Allahu ose mosveprimi i asaj që ka urdhëruar të veprohet.

- janë njerëz që i ka zgjedhur Allahu për t'i përcjellë mësimet e Tij tek njerëzit.

- quhet besimtari, i nënshtruar, i binduri ndaj Allahut.

- quhen thëniet, veprat dhe miratimet e Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem).
- i ka krijuar Allahu nga drita dhe i binden plotësisht Allahut.
- do të thotë Ai, të Cilin e adhuron çdo gjë, çdo krijesë.
- është frikë-respekti për Allahun dhe rruga e Profetit (salAllahu alejhi ue selem);
- i ka krijuar Allahu nga flaka dhe disa prej tyre i binden Atij e disa jo.
- është krijesa më e madhe që ka krijuar Allahu, mbi të cilën është Ai.
- Allahu i dërgoi ____ (kë?) që t'i thërrasin njerëzit për ta adhuruar Atë, të Vetëm dhe të largohen prej shirkut.
- Elhamdulillah, Allahu dhëntë suksese! Tani të gjithë fëmijët me radhë do i recitoni të tri hadithet e mësuara. Janë shumë të lehta dhe ju pa asnjë vështirësi do i recitoni ato.
- Çka na ka mbetur pa përsëritur? Shumë bukur, na kanë mbetur pesë emrat e Allahut. Cilët janë dy argumentet për emrat e Allahut? Sa emra ka Allahu? Cili është shpërblimi për besimtarin që i mëson 99 emra prej emrave të Allahut?
- Dëgjoni! Kështu si jeni ulur me radhë fëmija i parë thotë emrin e Allahut në gjuhën arabe, tjetri atë emër në gjuhën shqipe, tjetri kuptimin e tij dhe i katërti argumentin për të. (mund të konsultohen me libër për çdo rast).
- Sot kemi biseduar së bashku, gjithashtu kemi pasur mundësi të shikojmë në libër, ndërsa sot një javë të gjitha këto që i përsëritëm sot do i shkruani vet. Allahu ju bëftë prej më të dashurve të Tij! Esselamu alejkum!

Muaji shkurt, java e parë

Testimi për tre libërthat A-C (Testi në fund të këtij materiali). Mësimdhënësi jep sqarime për të gjitha kërkesat që në fillim të testit dhe pyet nëse ka ndonjë paqartësi tek fëmijët. Pastaj fillon testimi. Në shtëpi kontrollon testet, dhe në telefon privat ua komunikon pikët apo në shkollë.

Muaji shkurt, java e dytë

Mësimdhënësi:

- Keni pushuar? Libërthi i cilës shkronjë vjen me radhë? Tregimi në këtë libërth ndahet në dy pjesë për shkak të gjatësisë së tij. Keni ndonjë ide se pse është çudi lindja e Isait (alejhis selam)?
- Të lexojmë pjesën e parë të këtij tregimi së bashku me pyetjet e tij.
- Ka ndonjë fjalë të panjohur, të cilën nuk e kuptuat gjatë leximit të tregimit?
- Elhamdulillah, Allahu ju gëzoftë! Leximin e tregimit dhe fjalët e panjohura, si dhe përgjigjen e këtyre pyetjeve do i bëni në shtëpi.
- Të vazhdojmë me dy ushtrimet për këtë pjesë.

- Ushtrimi 1: “Lexo fjalitë për Merjemen. Ngjyros me të gjelbër katrorin ku është fjala e saktë, ndërsa me të kuqe ku është fjala e pasaktë.” E kemi dhe një shembull sesi të plotësohet ky ushtrim. Pra, fjalia: Populli hebre janë pasardhësit e profetit, cilit prej këtyre dy profetëve: Jakubit apo Ismailit? Jakub, që është e saktë, ngjyroset me ngjyrë të gjelbër, ndërsa Ismail, që nuk është e saktë, ngjyroset me të kuqe. Kështu vazhdohet me gjashtë fjalitë e radhës.

- E përfunduat? Lexojeni me radhë nga një fjali secili.

- Ushtrimi 2. Tek ky ushtrim kemi tri kërkesa. Së pari i bashkojmë rrokjet për të formuar fjalë. Pastaj kur t’i keni gjetur të gjitha fjalët (trembëdhjetë fjalët), do vazhdoni t’i gjeni të gjitha këto fjalë tek enigma në anën e majtë të faqes në të katër drejtimet sikur për fjalën “Profet”. Këtë lloj të enigmës jemi mësuar të plotësojmë pasi çdo libërth ka së paku një të tillë.

- I keni gjetur tek enigma të trembëdhjetë fjalët? A kanë mbetur ende shkronja në të? Kanë mbetur edhe gjashtëmbëdhjetë shkronja, të cilat do i shkruani tek tri vizat poshtë dhe të shikojmë çfarë po zbulojmë përsëri.

- Shihemi sot një javë, Allahu ua shtoftë mirësitë e vazhdueshme! Esselamu alejkum!

Muaji shkurt, java e tretë

Mësimdhënësi:

- Pyetje-përgjigjet e tregimit dhe fjalët e panjohura i kam parë në grupin e raportimeve, prandaj sot do i lexojmë me radhë ato. Fëmija i parë lexon pyetjen e parë i dyti përgjigjen e saj e kështu me radhë të gjithë fëmijët.

- Ku kemi mbetur tek tregimi? Kë e lind Merjemja e ndershme?

- Tani të vazhdojmë këtë tregim shumë shumë të rëndësishëm.

- Ka ndonjë fjalë të panjohur, të cilën nuk e kuptuat gjatë leximit të tregimit?

- Shumë mirë, keni diçka të paqartë në gjithë tregimin?

- Kaq për sot. Allahu ju begatofte me çdo mirësi! Esselamu alejkum!

Muaji shkurt, java e katrët

Mësimdhënësi:

- Si javën e kaluar, lexoni me radhë të gjithë fëmijët pyetjet e pjesës së dytë, të cilat i keni shkruar në fletore.

- Ma shaa Allah, kështu çdoherë iu përgjigjeni pyetjeve me fjali të plotë. Tani unë bëj disa pyetje nga të dy pjesët dhe ju do përgjigjeni.

- Elhamdulillah! Të fillojmë me ushtrimet të cilat do na ndihmojnë të kuptojmë mësimet dhe të përsërisim njohuritë e fituara deri tani.

- Ushtrimi 3. Këto fjali tregojnë për dy persona. Ju kur t'i lexoni ato do i gjeni se për kë bëhet fjalë, pastaj shkruani emrat e tyre. Pastaj fjalitë që tregojnë për ta tek emri i tyre i shkruani rreth emrit. Pra, është pemë e mendimeve me fjali të gatshme, vetëm se do t'i ndani ato drejt për secilin.

- Ushtrimi 4 ka tri kërkesa të lehta dhe argëtuese. Kur të plotësoni fjalëkryqin, kujdes, shikoni numrat e fjalive, sepse nuk janë sipas renditjes së tyre. Cila fjalë u formua? Pse është formuar kjo fjalë: mrekullitë? Sepse fjalitë e plotësuara tregojnë për disa nga mrekullitë e Isait (alejhis salam).

- Ushtrimi 5. Është përsëritje e fjalëve të panjohura që kemi mësuar edhe tek libërthat tjerë. Kujdes! Kërkohej të rrethohet përgjigjja e pasaktë, pra tri opsione janë të sakta dhe vetëm njëra nuk është e saktë. Këtë të pasaktën do e rrethoni ju.

- Vazhdoni të përsërisni e mësoni duke shpresuar shpërblimin e Allahut të Madhëruar dhe duke e lutur Atë për të na dhënë suksese, sepse çdo gjë arrihet vetëm me ndihmën e lejen e Allahut. Nga Allahu kërkojmë ndihmë e sukses në çdo gjë! Esselamu alejkum fëmijë të zgjuar!

Muaji mars, java e parë

Mësimdhënësi:

- Sa emra të Allahut së bashku me domethënie e kuptim si dhe me argumente kemi mësuar? Cilët janë ata? Së pari i thoni në gjuhën arabe, pastaj në gjuhën shqipe. Ju lumtë!

- Këtyre pesë emrave të Allahut sot do ua shtojmë edhe dy emra të ri.

- Si zakonisht, unë lexoj së pari dhe ju dëgjoni me vëmendje duke më përcjellë.

- Tani lexoni me radhë të gjithë fëmijët këta emra. Fëmija i parë lexon emrin dhe kuptimin e tij, ndërsa fëmija tjetër argumentin për të në gjuhën shqipe dhe arabe.

- Kemi dy ushtrime. Ushtrimi 6 thotë: “Ngjyros dy emrat e Allahut që i mësuam.”

- Ushtrimi 7. Ky ushtrim është i njëjtë me ushtrimin 11 të libërthit B ku e gjetëm argumentin për shirkun. Ndërsa këtu do i gjejmë shtatë emrat e Allahut në gjuhën shqipe. Kemi dhe shembullin e parë për të na e lehtësuar punën.

- I përfunduat? Tani lexoni me radhë emrat që i keni shkruar arabisht dhe shqip.

- Allahu ju shperbleftë me të mira! Esselamu alejkum!

Mesazhi i mësimdhënësit, dita e pestë:

Sot do i përsërisni duke i lexuar shtatë emrat e Allahut. Për të dalluar ata, aktivitet i lehtë dhe i dobishëm është shkrimi i tyre vetëm emri (pa kuptim dhe argument) në gjuhën arabe dhe gjuhën shqipe. Bile këtë bëjeni herë pas here vet.

Muaji mars, java e dytë

Mësimdhënësi:

- Lënda e akides, pra mësim-besimit është shumë e rëndësishme. Çka kemi mësuar deri tani tek ajo? Kemi mësuar për urdhrin më të rëndësishëm për të cilin na ka urdhëruar Allahu. Cili është ai? Shumë bukur, pra urdhri më i rëndësishëm për të cilin na ka urdhëruar Allahu është teuhidi. Çka do të thotë teuhid? Kush është argument për teuhidin? Shkëlqyeshëm! Po e keqja apo gjynahu më i madh, cili është? Ju lumtë, është shirku. Çka do të thotë shirk? Kush është e kundërta e shirkut? Kemi marrë argument një ajet dhe një hadith. Cili ajet është argument që shirku është mëkati më i madh? Të lumtë! Allahu ua shtoftë dijen e dobishme! Po hadithi cili është? Elhamdulillah sa bukur. Kë ka zgjedhur Allahu për t'i përcjellë mësimet e Tij tek njerëzit? Bravo, pra ka zgjedhur profetët e Tij? Kush janë profetët? Po pra, profetët janë njerëz që i ka zgjedhur Allahu për t'i përcjellë mësimet e Tij tek njerëzit. Kur i dërgoi Allahu profetët? Allahu i dërgoi profetët atëherë kur popujt filluan të adhuronin zota të tjerë në vend të Tij dhe të bënin vepra të liga. Mësimi i kaluar në akide ishte? Elhamdulillah! Ishte "Përse Allahu i dërgoi profetët?". Argumenti për këtë që u tha është?

- Shumë mirë. Sot do mësojmë një mësim të ri, i cili është shumë i lehtë dhe ju të gjithë e dini atë, por ka rëndësi shumë të madhe. Ai mësim është: "Cila është feja jote?" E dini kush është feja juaj? Dëgjoni tani.

Lexojnë fëmijët me radhë. Pas leximit të disa fëmijëve, si çdoherë që e kemi këtë metodë, tjerët që e mësojnë përmendsh gjatë këtyre leximeve e recitojnë atë.

- Jeni lodhur? Jo nuk lodheni ju, sidomos kur e kujtojmë shpërblimin e pakufishëm të Allahut për këtë vepër aq të madhe e të rëndësishme. Cila është kjo vepër? Pra, mësimi i dijes. Tani pak të pushojmë duke e plotësuar këtë sudok me shkronjat e fjalës "FEJA". Si plotësohet sudoku? Të gjitha shkronjat e kësaj fjale duhet të ndodhen në rreshtat horizontalisht, vertikalisht dhe në katër katrorët e sudokut. E nëse në ndonjërin rresht janë dy shkronja të njëjta i bie që njëra nga shkronjat mungon.

- Ushtrimi 9: "Zbulo fjalët tek kolona B duke u ndihmuar nga kolona A. Çfarë zbulove?" Pra, katrori ku është i shkruar numri 1 i kolonës B, tek kolona A cila shkronjë është në atë katror që ka të njëjtin vend? Po pra, është shkronja F. E shkruani shkronjën F tek fjala e parë në fjalinë poshtë. Pas saj cila shkronjë vjen, tani duhet rreshti i dytë tek katrori gjashtë? Është shkronja E. Kështu me radhë gjeni të katër fjalët për të formuar fjalinë e dhënë.

- Allahu ju ruajttë dhe dhëntë gjitha të mira! Esselamu alejkum!

Mesazhi i mundshëm i mësimdhënësit në grupin e raportimit, dita e tretë e kësaj jave:

Esselamu alejkum ue rahemtullahi ue berekatuhu!

Në fletoren e mësim-besimit shtoni mësimin e ri që mësuam, si zakonisht ju edhe e lexoni atë pasi ta shkruani.

Shembull se si të shkruhet raportimi:

Numri i renditjes së fëmijës gjatë raportimit dhe emri i tij.

Elhamdulillah e kam shkruar mësimin: “Cila është feja jote?” në fletore, pastaj e kam lexuar.

Mesazhi i mundshëm i mësimdhënësit në grupin e raportimit, dita e gjashtë e kësaj jave:

Esselamu alejkum ue rahemtullahi ue berekatuhu!

Sot raportoni pasi të keni lexuar fjalët e panjohura të dy pjesëve të tregimit. Gjithashtu lexoni edhe dy emrat e ri të Allahut që i mësuam.

Shembull se si të shkruhet raportimi:

Numri i renditjes së fëmijës gjatë raportimit dhe emri i tij.

Elhamdulillah i lexova fjalët e panjohura dhe dy emrat e fundit të Allahut.

Muaji mars, java e tretë

Mësimdhënësi:

- Sot po e përfundojmë edhe libërthin e katërt dhe të parafundit, ma sha Allah tebarekAllah. Kush e thotë hadithin “Shtyllat e Islamit”? Tani hadithin e dytë: “Bazat e Imanit”? Po hadithin e tretë? Shkëlqyeshëm.
- Me radhë është hadithi i katërt, dëgjoni me vëmendje duke më përcjellë.

Lexojnë dy-tre fëmijë, derisa të tjerët që e kanë mësuar atë përmendsh e recitojnë para tjerëve.

- Ushtrimi 10: “Shkruaj katër hadithet e mësuara duke gjetur rrugën te cili libërth është secili prej tyre.” Ne përveç që duam të mësojmë gjithashtu duam edhe t’i punojmë duke i zbukuruar ato. Prandaj, më mirë rrugën e libërthit të shkronjës A e gjeni me ngjyrën e kuqe (ashtu si është ngjyra e shkronjës këtu), ku në fund të saj e shkruani hadithin e këtij libërthi. Rrugën e libërthit të shkronjës B e gjeni me ngjyrën e kaltër. Kështu me radhë të katër hadithet e mësuara.
- E përfunduat detyrën. Elhamdulillah, shkëlqyeshëm. E vazhdoni në shtëpi kush nuk ka arritur të përfundojë atë.
- Tani është faja e fundit. Në raporte keni bërë përsëritjen e njohurive të këtij libërthi, prandaj do ta keni shumë të lehtë plotësimin e saj. Si zakonisht gjatë plotësimit të faqes së fundit nuk duhet të komunikoni mes vete, përqendrohuni në plotësimin e faqes suaj sa më mirë.

Muaji prill, java e parë

Mësimdhënësi:

- Ku kemi arritur? Kemi arritur në libërthin e fundit për këtë vit, të nivelit të parë. Të gjejmë disa fjalë fetare që fillojnë me shkronjën D.
- Në tregim bëhet fjalë për Davudin (alejhis selam). Keni dëgjuar më përpara për këtë profet?
- Si çdoherë unë e lexoj tregimin, ju dëgjoni me vëmendje. Gjatë leximit të tregimit unë bëj pyetje për pjesën e lexuar dhe ju përgjigjeni. Të fillojmë, bismil-lah.
- Ka ndonjë fjalë të panjohur? Në libër kemi pesë fjalë të sqaruara, të cilat kanë lidhje me gjuhën shqipe. Janë të rëndësishme gjithsesi t'i lexoni e mësoni sepse iu duhen.
- Tani kemi ushtrimet e bukura, të dashura e të dobishme, elhamdulillah.
- Ushtrimi 1: “Formo emrin *DAVUDI* me shkronjat poshtë. Sa herë arrite të formosh këtë emër? Shkronjat e tepërta shkruaji dhe zbuloni me to një emër të rëndësishëm të cekur në tregim.” Kështu, për të dalluar më lehtë sa herë keni gjetur emrin *DAVUDI*, i ngjyrosni me ngjyra të ndryshme, p.sh. me ngjyrën e kuqe rrethoni shkronjat *DAVUDI*, pastaj me ngjyrën e kaltër këto shkronja, pastaj me ngjyrën e gjelbër, deri të harxhohen këto shkronja dhe pastaj vetëm ngjyrat e numëroni dhe gjeni sa herë është formuar ky emër. Sa shkronja kanë mbetur tepër? I shkruani ato tek pjesa “shkronjat e tepërta” dhe pastaj me këto shkronjat zbuloni cila fjalë është e shkruar. E gjetët? Ma shaa Allah.
- Ushtrimi 2: “Plotëso fjalëkryqin me fjalët përbërëse të tregimit duke marrë për bazë numrin e shkronjave të tyre.” Pra, e kuptuat kërkesën? E shikoni numrin e fjalëve dhe kështu plotësohet ky fjalëkryq interesant. E kemi të shkruar fjalën më të gjatë. Për të lehtësuar akoma më shumë i shkruajmë fjalët, të cilat janë vetëm nga një fjalë me aq shkronja. Cilat fjalë tjera janë të vetme tek kategoria e tyre? Po ashtu është, është fjala që ka dhjetë shkronja, gjithashtu ajo që ka tetë shkronja. Gjeni së pari këto fjalë duke i shkruar, pastaj duke u ndihmuar me këto fjalë të shkruara gjeni tjerat.
- Ushtrimi 3. Është e qartë kërkesa? Ja si në shembull: gjatë leximit të fjalisë e gjeni nëse është e saktë apo e pasaktë ajo. Nëse është e saktë, e rrethoni shkronjën nën kolonën e të saktës, ndërsa nëse është e kundërta atëherë tek e pasakta. Lexoni tani fjalitë me radhë kështu si jeni ulur. Fëmija i parë lexon fjalinë e parë duke treguar nëse është e saktë apo e pasaktë ajo. Pastaj vazhdon fëmija i radhës me fjalinë e dytë deri të përfundojnë fjalitë. Shumë bukur. Tani shkruani shkronjat e rrethuara tek vendi i rezervuar për to. Çfarë qenka fshehur pas tyre?
- Ushtrimi 4. E vazhdoni në shtëpi, sepse nuk ka kohë.
- Allahu ju shpërbleftë me të mira! Esselamu alejkum!

Muaji prill, java e dytë

Mësimdhënësi:

- Sot një javë kemi lexuar tregimin për Davudin (alejhis selam) dhe po ashtu gjatë javës e kemi përsëritur atë. Cilët emra të Allahut janë cekur në tregim? Po pra, ju lumtë sa fëmijë të zgjuar, Allahu ju ruajttë!
- Pra, sot i kemi dy emra të lehtë, të cilët gjithashtu kanë të dy argumentin e njëjtë. Cilët janë emrat tjerë të Allahut për të cilët kemi marrë argumentin e njëjtë?
- Kemi mësuar gati një vit së bashku dhe e dimë si mësojmë. Pra, unë lexoj e ju dëgjoni me vëmendje. Pastaj lexoni të gjithë fëmijët këta emra.
- Ushtrimi 5: “Ngjyros dy emrat e Allahut që i mësuam.”
- Ushtrimi 6: “Shkruaj emrat e Allahut në gjuhën shqipe pranë atyre në gjuhën arabe si në shembull. Pastaj gjej këta emra (pa dyfishimin e shkronjave) tek enigma poshtë ↔↑.” Është sqaruar shumë qartë kërkesa e ushtrimit. E kuptuat çfarë kërkohet? Shikoni në shembullin e dhënë dhe vazhdoni kështu me të gjithë emrat.
- Kush nuk ka arritur të përfundojë ushtrimin, e vazhdon në shtëpi.
- Ushtrimi i fundit për sot, ushtrimi 7, i cili po ashtu është shumë i qartë. Vazhdoni t'i lidhni emrat tjerë me kuptimet e tyre. Fillon emrin e parë njëri prej fëmijëve, dhe kështu të gjithë me radhë lexojnë emrat me kuptimet e tyre.
- Ushtrimin tjetër do e plotësojmë javën e ardhshme së bashku me punimin e gjashtë emrave të mësuar për t'i vendosur në mur. Allahu ju gëzoftë! Esselamu alejkum!

Muaji prill, java e tretë

Mësimdhënësi:

- Çfarë mësuam javën e kaluar? Kush e reciton emrin e Allahut “El-Hamidu”? Po emrin tjetër “El-Mexhidu”? TeberakAllah. Na ka mbetur ushtrimi 8 pa plotësuar. E plotësuat? Lexojeni me radhë secilin emër nga një fëmijë bashkë me argumentin për të.
- Elhamdulilah shumë mirë. Çka do bëjmë në vazhdimin e orës?
- Do punojmë në grup. Si do punoni? Do e mbushni punimin “Emrat e bukur të Allahut” me emrat e ri që i kemi mësuar. Sa emra i kemi mësuar e që nuk i kemi punuar në këtë punim? Vazhdoni kështu të ndarë në grupe të zbukuroni emrat e caktuar, pastaj i ngjisni ata në punim. Allahu ju dhëntë sukses! Amin!
- Bashkëpunoni mes vete, jo vetëm për vete.

- O ma shaa Allah. Shumë mirë, keni shkruar drejt emrat edhe me shkronja arabe e në gjuhën shqipe. Ja shikoni nga larg sa është zbukuruar, jo vetëm punimi por gjithë kjo pjesë e murit.
- Allahu ju shpërbleftë me të mira! Esselamu alejkum!

Muaji prill, java e katërt

Mësimdhënësi:

- Mësimi i ri nga akideja është: “Cili është Profeti yt?”. Dëgjoni me vëmendje!
- Kështu si jeni ulur do lexoni të gjithë fëmijët me radhë këtë mësim. Kush e mëson përmendsh e reciton që sot.
- Elhamdulillah, elhamdulillah çfarë fëmijë kemi, Allahu ju ruajttë!
- Me radhë është ushtrimi 9, i cili është më shumë argëtues. Si zakonisht gjeni me ngjyra të ndryshme këto tri rrugë.
- Ushtrimi 10 kemi përsëritje të mësimave nga akideja duke rrethuar përgjigjen e saktë. Kujdes! Mos u ngutni lexoni mirë opsionet e ofruara.
- Lexoni me radhë të gjithë fëmijët. Mos harroni t'i lexoni të gjitha opsionet e pastaj jep përgjigjen e saktë.
- Allahu ua shtoftë të gjitha mirësitë të dashur fëmijë! Esselamu alejkum!

Muaji maj, java e parë

Mësimdhënësi:

- Erdhëm tek fundi, subhanAllah sa shpejt.
- Tani më tregoni sa hadithe i kemi mësuar përmendsh? (Për katër hadithet recitojnë fëmijë të ndryshëm.)
- Sot do të mësojmë një hadith të ri. Çka do të thotë hadith? Po pra, hadith quhen thëniet, veprat dhe miratimet e Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem). Hadithet fillojnë me: ka thënë Muhamedi (salAllahu alejhi ue selem). Tash dëgjoni hadithin e ri, si zakonisht unë e lexoj së pari, pastaj lexoni dy-tre prej jush. Ata që veç e mësojnë përmendsh gjatë kësaj kohe sa lexojmë, mund ta recitojnë përmendsh. Allahu ju begatofte me gjitha të mirat!
- Ushtrimi 11 është edhe labirint edhe plotësim i tri haditheve që tashmë vetëm i dimë përmendsh. Çka do të bëni ju? Pjesën e parë të secilit hadith do t'ia gjeni rrugën, me ngjyra të veçanta, për tek pjesa e dytë e tij. A ua gjetët të tri haditheve rrugët për tek pjesët tjera? Allahu ju dhëntë të mira! Tani shkruani komplet të tri hadithet. Shkëlqyeshëm.
- Dhe në fund është faqja e fundit. Filloni me plotësimin e saj.
- Allahu ju shpërbleftë me të mira! Ilustrimin e kopertinës e bëni në shtëpi. Esselamu alejkum!

Literatura

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Fjalor i shqipes së sotme*, "Botimet Toena", Tiranë, 2002.

Kurani i madhërishëm, Në përkthimin e prof. Hasan I. Nahut, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2006.

Sherif Ahmeti, *KUR'AN-i Përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, "Kompleksi i Shërbyesit të Dy Haremave, Mbretit Fehd", Medine, 1413 H.

Dr. Muhamed Taki-ud-Din El-Hilali dhe Dr. Muhamed Muhsin Khan, *Shpjegimi i kuptimeve të Kur'anit të Lartë*, "DARUSSALAM", Riad, Arabia Saudite, 2000.

Hafidh ibën Kethir, *Rrëfime për të Dërguarit e Allahut (paqja e Allahut qoftë mbi ta!)*, "Gjurma-botime", Prishtinë, 2007.

Safijurrahman el-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit*, "Urtësia", Shkup, 1997.

Seid El-Kahtani, *Mburoja e myslimanit*, "NuN", Shkup, 2011.

Akideja Tahavije, Imam Tahaviu me komente të Shejh Muhammed Nasiruddin Albani, "Essebil", 2008.

Muhammed ibn Salih El-Uthejmin, *Komentari i xhuzit "Amme"*, "Essebil", 2018.

Abdur-rahman ibn Nasir El Sa'dij, *Tefsiri Kur'ani vëllimi i katërt*, "Botimet LSH", Tiranë, 2013.

Abdulmuhsin ibën Hamed el Abad, *Erdhi t'ju mësojë Fenë tuaj*, Boton "Qendra Imam Albani".

Muhamed Temimi, *T'ua mësojmë fëmijëve besimin!*, Përktheu Petrit Perçuku.

Shejh Jahja el Haxhuri, *Parime të dobishme*, ril-al.com, 2013

Abdul Muhsin el Abad, *Sqarimi i dyzet haditheve të Neveviut (dhe shtojcës së Ibn Rexhebit)*, Botimet "Qendra Imam Albani", 2009.

Akidja e muslimanit sunni, Qendra "Imam Albani" Jordani, Botimi i dytë, 2006.

Abdulaziz bin Abdilah bin Baz, *Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë*, Përktheu Bledar Aliu. (www.mburoja.net)

Salim bin Sa'd Et-Tauil, *Pyetje për të vegjlit për të cilat kanë nevojë të rriturit*, Prishtinë, 2014.

Hejthem Serhan, *Libri i Teuhidit dhe Akides*, “Gjurmet e Dijes”.

Abdurrezak ibn Abdul Muhsin El Bedr, *Fikhul Esmail Husna*, “Daru Et-teuhid”, Er-Rijad.

Musa Riçardson, *Akide- Udhëzues për mësues, Niveli i parë*. (www.mburoja.net)

Albana Tare (Kadiu), *Provo veten në test! 1*, “Extra”, Elbasan, 2010.

Albana Tare (Kadiu), *Provo veten! Mua më ke pranë! 2*, “Extra”, Elbasan, 2005.

Nadire Nuredini – Natasha Pepivani, *Fletore pune për gjuhën Shqipe, (klasa e dytë)*, “Albas”, Prishtinë, 2007.

Nga interneti

www.activityvillage.co.uk

www.facebook.com/keshilladobishme

<https://fjale.al/>

www.kids-pages.com

ligjeratalulzimpercuku.wordpress.com

www.mburoja.net

www.rrugetepaqes.net

www.udhaebesimtareve.com

I gjithë lavdërimi dhe falënderimi i përket Allahut, Zotit të botëve!

Kontrollim njohurish A-C

Data: _____

Emri: _____

1. Shkruaj përgjigjen me fjali të plotë.

- 1) Kush është Zoti ynë? _____
- 2) Ku është Allahu? _____
- 3) Përse na ka krijuar Allahu? _____

- 4) Çka është adhurimi? _____

- 5) Sa vite fjeten djemtë e rinj? _____
- 6) Pse u fshehën djemtë e rinj në shpellë? _____
- 7) Kush quhet besimtar? _____

- 8) Kush janë profetët? _____
- 9) Kur i dërgoi Allahu profetët te njerëzit? _____
- 10) Cili është obligimi ynë ndaj profetëve? _____

2. Tek definicionet shkruaj fjalën për kë bëhet fjalë.

(Allahu, profetët, Arshi, Adhurimi, Besimtarë, Profetët, Idhull, Shirku, Teuhid, Mysliman, Engjëjt, Devotshmëri, Mëkat, Xhinët, Hadith)

- 1) _____ quhen njerëzit të cilët i besojnë Allahut dhe të Dërguarit, Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem) dhe çdo gjë që na ka treguar Ai dhe i Dërguari i Tij.
- 2) _____ është çdo vepër dhe fjalë që e do Allahu dhe është i kënaqur me të, qoftë e jashtme apo e brendshme.
- 3) _____ është ta adhurosh dikë tjetër përveç Allahut apo bashkë me Të.
- 4) _____ është çdo gjë që adhurohet përveç Allahut dhe ka formë të caktuar, i ka dhënë formë njeriu.
- 5) _____ do të thotë të besojmë bindshëm dhe të pranojmë se Allahu është i Vetëm e i pa shoq në gjërat që Ai i meriton dhe që veçohet me to.
- 6) _____ është veprimi i asaj që e ka ndaluar Allahu ose mosveprimi i asaj që ka urdhëruar të veprohet.
- 7) _____ janë njerëz që i ka zgjedhur Allahu për t'i përcjellë mësimet e Tij tek njerëzit.
- 8) _____ quhet besimtar, i nënshtruar, i binduri ndaj Allahut.
- 9) _____ quhen thëniet, veprat dhe miratimet e Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem).
- 10) _____ i ka krijuar Allahu nga drita dhe i binden plotësisht Allahut.
- 11) _____ do të thotë Ai, të Cilin e adhuron çdo gjë, çdo krijesë.
- 12) _____ është frikë-respekti për Allahun dhe rruga e Profetit (salAllahu alejhi ue selem);
- 13) _____ i ka krijuar Allahu nga flaka dhe disa prej tyre i binden Atij e disa jo.
- 14) _____ është krijesa më e madhe që ka krijuar Allahu, mbi të cilën është Ai.
- 15) Allahu i dërgoi _____ që t'i thërrasin njerëzit për ta adhuruar Atë të Vetëm dhe të largohen prej shirkut.

3. Shkruaj emrin e Allahut në gjuhën shqipe. Lidh me shigjetë emrat e Allahut me kuptimet e tyre.

All-Ilahu	Mëshira e Allahut është gjithëpërfshirëse, i përfshinë të gjitha krijesat e Tij.
Err-Rabbu	Allahu është Ai që krijon, sundon, posedon dhe drejton e rregullon të gjitha çështjet.
Err-Rrahmanu	Ky është emri më i madh i Allahut. Çdo emër tjetër i bukur i Allahut vjen si tregues për Të. Allah do të thotë Ai të Cilin e adhuron çdo gjë, çdo krijesë.
Err-Rahimu	Mëshira e Allahut është e veçantë vetëm për besimtarët në Ditën e Gjykimit.
El-Ilahu	Allahu është i Vetmi që meriton të adhurohet.

___ / 10

4. Shkruaj tri hadithet e mësuara.

Ka thënë Muhamedi (salAllahu alejhi ue selem):

1) "Islami qëndron _____

_____ (Muslimi)

2) "Imani (besimi) është: _____

_____ (Muslimi)

3) "Profetët _____ (Buhariu, Muslimi)

___ / 5

Gjithsej: ___ / 50

Esselamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Çdo lavdërim dhe falënderim i përket Allahut, Zotit të botëve. Salati dhe selami qofshin për robin dhe të Dërguarin e Allahut, Muhamedin, për familjen e tij dhe për të gjithë shokët e tij!

Sot jemi mbledhur këtu me rastin e përfundimit të suksesshëm të nivelit të parë nga libri “Tregimet më të bukura”. Për rreth një vit jemi njoftuar dhe kemi mësuar tregime, emra të Allahut, mësim nga akideja dhe hadithe. Të gjitha këto njohuri na janë bërë shumë më të lehta për mësim e më tërheqëse, pa harruar edhe përfitime tjera të shumta, përmes enigmave të ndryshme e atraktive, si: fjalëkryqe, gjej fjalët, labirinte, rendit fjalët etj.

1. Së pari do fillojmë me recitimin e sures El-Fatiha nga ... (emri i fëmijës).
2. Fëmijët janë të ndarë në dy (apo katër) grupe. Për më sigurt kemi dhe komisionin që do kontrollojë përgjigjet dhe për vlerësimin.

Tani do fillojmë me garën e diturisë. Unë do të lexoj pyetjen, grupi do të ketë kohë të mendojë një minutë dhe pastaj të japë përgjigjen. Me këtë formë do vazhdohet me të dy (katër) grupet.

3. Fjalët e Allahut në Kuranin fisnik na qetësojnë dhe bëhen shkak për të vazhduar me sukses, përveç mësimave pa fund, elhamdulillah Rabbil alemin! Të dëgjojmë suren ... (nga suret e shkurtëra) të recituar nga ... (emri i fëmijës).

4. Pjesa e dytë e grupeve është me kuizin, pra rretho të saktën. Përsëri unë lexoj pyetjen, grupi ka kohë të mendojë një minutë e pastaj e jep përgjigjen e saktë.

5. Profeti ynë i dashur (salAllahu alejhi ue selem) na ka treguar që për leximin e vetëm të një shkronje të Kuranit Allahu na jep dhjetë shpërblime, subhanAllah. Mirëpo, leximi i Kuranit edhe me komentim është akoma më mirë. Prandaj, tani ... (emri i fëmijës) do recitoj suren ... (nga suret e shkurtëra), ndërsa ... (emri i fëmijës) do e lexojë kuptimin e saj në gjuhën shqipe.

6. Gara do të vazhdojë me lojën e asociacioneve.

E mira e gjithë kësaj është se këto njohuri janë vetëm fillimi, pasi kemi edhe pesë nivele të tjera për të përfunduar këtë libër. Allahu na bashkoftë çdoherë në të mira e suksese! Amin!

Dhe për fund kemi nga një dhuratë të mrekullueshme. Allahu ju dhëntë mirësi të vazhdueshme! Amin! Esselamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

Pika 2

1. Kush është Zoti ynë?

Zoti ynë është Allahu.

2. Ku është Allahu?

Allahu është lartë mbi shtatë qiej, mbi Arsh. Allahu është mbi çdo gjë.

3. Çka ka krijuar Allahu?

Allahu ka krijuar çdo gjë, ato që i shohim dhe që nuk i shohim.

4. Përse na ka krijuar Allahu?

Allahu na ka krijuar neve që ta adhurojmë vetëm Atë, pa i shoqëruar asgjë.

5. Si i bindemi ne Allahut?

Ne i bindemi Allahut duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij.

6. Çka është adhurimi?

Adhurimi është çdo vepër dhe fjalë që e do Allahu dhe është i kënaqur me të, goftë e jashtme apo e brendshme. Kur i lutemi Allahut ky është adhurim, po ashtu kur falemi, agjërojmë, dëgjojmë prindërit, flasim fjalë të mira, i ndihmojmë më të vjetërve etj.

7. Kush quhen besimtarë?

Besimtarë quhen njerëzit të cilët i besojnë Allahut dhe të Dërguarit, Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem) dhe çdo gjë që na ka treguar Ai dhe i Dërguari i Tij. Ata i luten vetëm Allahut, i veprojnë gjërat që na ka urdhëruar Ai dhe largohen nga ato që na ka ndaluar Ai. E kundërta e fjalës besimtarë është jobesimtarë.

8. Çka do të thotë teuhid?

Teuhidi është urdhri më i rëndësishëm për të cilin na ka urdhëruar Allahu. Teuhid do të thotë të besojmë bindshëm dhe të pranojmë se Allahu është i Vetëm e i pa shoq në gjërat që Ai i meriton dhe që veçohet me to.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë..." (En-Nisa, 36)

"Thuaj: Ai është Allahu, Një. Allahu është Absoluti. Ai as nuk ka lindur dhe as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (i ngjashëm) me Të." (El-Ihlas, 1-4)

9. Çka është shirku?

Shirku është e keqja (gjynahu) më e madhe. Shirk do të thotë ta adhurosh dikë tjetër përveç Allahut apo bashkë me Të.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Vërtetë Allahu nuk fal që t'i bëhet Atij shirk, ndërsa mëkatet tjera ia fal kujt të dojë." (En-Nisa, 48)

Si dhe hadithi:

"Është pyetur Muhamedi (salAllahu alejhi ue selem): "Cili është mëkati më i madh?"

Ka thënë: "*Të bësh dikë të barabartë me Allahun, ndërkohë që Ai të ka krijuar.*" (Buhariu dhe Muslimi)

10. Përse Allahu i dërgoi profetët?

Allahu i dërgoi profetët që t'i thërrasin njerëzit për ta adhuruar Atë të Vetëm dhe të largohen prej shirkut.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!" (En-Nahl, 36)

11. Cila është feja jote?

Feja ime është Islami.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

"Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami." (Al-Imran, 19)

"Kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe në botën tjetër do të jetë i humbur." (Al-Imran, 85)

12. Cili është Profeti yt?

Profeti im është Muhamed ibn Abdullah, i Dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ue selem).

Argument për këtë është Fjala e Allahut:

"Muhamedi është i Dërguari i Allahut." (El-Fet'hu, 29)

Si dhe hadithi, ku i Dërguari i Allahut (salAllahu alejhi ue selem) ka thënë:

"Kush thotë: Jam i kënaqur që Zoti im është Allahu, feja ime është Islami dhe Profeti im është Muhamedi (salAllahu alejhi ue selem), këtij njeriu i bëhet obligim Xheneti." (Ebu Davudi, Es-Silsiletu Es-Sahihah)

Pika 4

1. Kë e ka krijuar Allahu me dy Duart e Tij?
 - a) Xhibrilin.
 - ☒ b) profetin Adem.
 - c) profetin Muhamed.
 - d) Hauanë.
2. Kë e ka marrë Allahu për mik (halil)?
 - ☒ a) profetët Ibrahim dhe Muhamed.
 - b) profetët Adem dhe Musa.
 - c) profetin Davud.
 - d) profetin Jusuf.
3. Sa emra ka Allahu i Lartësuar?
 - a) nëntëdhjetë e nëntë emra.
 - ☒ b) më shumë se nëntëdhjetë enëntë emra.
 - c) vetëm një emër: Allahu.
 - d) pesë emra.
4. Cili profet ka lindur pa baba?
 - a) profeti Ibrahim.
 - ☒ b) profeti Isa.
 - c) profeti Davud.
 - d) profeti Musa.
5. Sa vite fjetën djemtë e rinj?
 - a) njëqind vite.
 - b) dyzet vjet.
 - ☒ c) treqind e nëntë vjet.
 - d) një ditë.

6. Kuptimi i cilit emër të Allahut është: “Mëshira e Allahut është gjithëpërfshirëse, i përfshinë të gjitha krijesat e Tij.”?
- a) All-llahu.
 - b) El-Kajjumu.
 - ☒ c) Err-Rrahmanu.
 - d) Err-Rrazzaku.
7. Si përshtatet emri i Allahut Err-Rrabu në gjuhën shqipe?
- a) i Gjithëmëshirshmi.
 - b) i Fuqishmi.
 - ☒ c) Zoti.
 - d) i Gjithëfuqishmi.
8. Kush është shtylla e fundit e Islamit?
- a) Shehadeti.
 - ☒ b) Haxhillëku
 - c) Kaderi
 - d) Namazi.
9. Cili nga profetët ishte edhe mbret i popullit të tij?
- a) profeti Jusuf.
 - b) profeti Isa.
 - ☒ c) profeti Davud.
 - d) profeti Ibrahim.
10. Prej cilit profet e kanë prejardhjen të hebrenjtë?
- a) profetit Isa.
 - ☒ b) profetit Jakub.
 - c) profetit Jusuf.
 - d) profetit Nuh.

11. Cilën grua Allahu e zgjodhi mbi të gjitha gratë e botës?
- a) Asijen, gruan e Faraonit.
 - ☒ b) Merjemen, nënën e profetit Isa.
 - c) Fatimen, vajzën e profetit Muhamed.
 - d) Hadixhen, gruan e profetit Muhamed.
12. Cili është emri më i madh i Allahut?
- a) Err-Rrabu;
 - ☒ b) All-llahu;
 - c) El-Meliku;
 - d) Err-Rrahmanu.
13. "Çdo gjë që adhurohet përveç Allahut dhe ka formë të caktuar." ka kuptimin:
- ☒ a) idhulli;
 - b) gjynahu;
 - c) Dexhalli
 - d) bidati.
14. Shehadeti, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhillëkut, janë shtyllat e:
- a) Imanit
 - ☒ b) Islamit
 - c) Ihsanit
 - d) namazit.
15. Besimi në Allahun, engjëjt, librat, profetët, Ditën e Fundit dhe Kaderin, qoftë i mirë apo i keq, janë bazat e:
- a) Ihsanit
 - b) Islamit
 - ☒ c) Imanit
 - d) adhurimit.
16. Cili është profeti i fundit tek hebrenjtë dhe i parafundit prej profetëve?
- a) profeti Muhamed.
 - b) profeti Musa.
 - ☒ c) profeti Isa.
 - d) profeti Nuh.

Pika 6: dy lojërat me asociacione

